



ALUMNI JOURNAL

SUCCEED WITH QUALITY

Prill 2015

**MJAFTON VULLNETI DHE DËSHIRA,
SUKSESI ARRIHET NË UBT**

Hekuran Popaj

**KONFERENCA
"DITËT AUSTRIAKE-KOSOVARE 2015"**

**VIZIONI I QARTË DHE
PUNA SISTEMATIKE – ÇELËS I SUKSESIT**

Albert Mustafa

**ADRIANA BOERSMA:
"INTERNETI U KA NDIHMUAR
NJERËZVE NË NDRYSHIMIN E BOTËS"**

**DIJA DHE DIPLOMA E UBT-SË,
GARANCI PËR PUNËSIM**

Rrezart Prebeza

**UBT PREZANTOI
QENDRËN PËR SIGURI
KIBERNETIKE DHE PRIVATËSI**

**NË UBT PËRFITUAM NGA PROFESORËT
SHUMË TË PËRGATITUR PROFESIONALISHT**

Berna Devexhiu

**VIZITAT STUDIMORE,
NJË PËRVOJË E PAHARRUESHME**

Nexhmija Nuza

Në këtë numër:

Editoriali	3
Në UBT i zhvilloi punimet konferenca "Ditët Austriake-Kosovare 2015"	4
Korrektësia në vlerësim dhe nxitja e zhvillimit të ligjëratave përmes debatit - faktor në arritjen e rezultateve	7
Përvojat e fituara në UBT më kanë shërbyer shumë në ngritjen time profesionale	7
Mjafton vullneti dhe dëshira, suksesi arrihet në UBT	9
Rezultatet e mira duan shumë punë dhe përkushtim	10
Gara bëhet për dije, jo për nota!	11
Njohuritë e fituara në UBT mund të aplikohen suksesshëm në biznes për të krijuar avantazh konkurrues	12
Në studime master dhe në Zyrën për Projekte në UBT	13
Vizioni i qartë dhe puna sistematike – çelës i suksesit	14
Në UBT përfituam nga profesorët shumë të përgatitur profesionalisht	15
Dija dhe diploma e UBT-së, garanci për punësim	16
UBT prezantoi Qendrën për Siguri Kibernetike dhe Privatësi	17
UBT dhe Universiteti "Corvinus" nënshkruan memorandum të mirëkuptimit	18
Në UBT u mbajt sesiioni informativ për bursat e Forumit Evropian të Alpbach dhe IG Alpbach Kosova	19
Nga UBT në Gjovik në Norvegji e pastaj master në SHBA	20
Shkathësitë e shkëlqyeshme profesionale çdo ditë i praktikon në punë	21
Njohuritë e studimeve, ndihmesë e madhe për punën në praktikë	21
Teknologjia në shërbim të Shëndetësisë dhe të Edukimit	22
Erhard Busek: Duhet të shikoni me një vizion më të qartë që të zhvilloheni dhe të bëheni më të mirët	24
Nga UBT në Ministrinë e FSK-së	27
Pjesëmarrja në projektimin e kampusit të ri të UBT-së, një ndjenjë e veçantë	28
Të jesh arkitekt nuk nënkupton mësimin shabllon, por ballafaqimin me realitetin tonë	29
Studimet në arkitekturë, një eksperiencë unike	29
Vizitat studimore, një përvojë e paharrueshme	30
Të jesh pjesë e UBT-së është nder dhe privilegj	30
Me punë sistematike arrihet gjithnjë rezultat	31
Projektet e punuara në UBT e bënë një hulumtuese të mire	31
Ish-studenti i UBT-së, Kemajl Zariqi pronar dhe drejtues i Fabrikës së Veglave në Ferizaj	32
Kamer Borovci drejtues i kompanisë së suksesshme "Brickos SHPK"	33
Suksesi vjen tek ata që janë shumë të zënë duke e kërkuar atë	34
Studenti i UBT-së themelues i kompanisë prestigjioze	35
Certifikim ndërkombëtar për menaxhimin e projekteve	36
Profesorët e UBT-së në takimin selektues të organizuar nga projekti ERASMUS MUNDUS "Sigma Agile"	36
UBT organizoi punëtori me ekspertë ndërkombëtarë për themelimin e inkubatorit të biznesit	36
Meteorologjia aeronautike, pjesë e rëndësishme e operimeve në ANP-Kontrolli ajror "Adem Jashari"	37
Fotoreportazh	38

Impresum

UBT Alumni Journal
 Botues: Edmond Hajrizi
 Dizajni: Rexhep Kera
www.ubt-uni.net



UNIVERSITY EDUCATION FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY
 AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

Editorial

UBT dhe Alumni – një lidhje e përhershme



Dr. Edmond Hajrizi
President i UBT-së

Të nderuar anëtarë të alumnit të UBT-së,

Keni para jush numrin e ri të revistës suaj, “UBT Alumni”. Përveç kontakteve tona të përhershme, kjo revistë shënon dhe dokumenton, e ruan dhe e zhvillon lidhjen tonë, lidhjen e përhershme mes juve dhe UBT-së.

Me vite, UBT është rritur dhe në shumë fusha mban pozitën e liderit, jo vetëm në vendin tonë por edhe më gjerë. Siç e dini, përveç hapjes së degëve të reja të studimeve, që po shtohen në vazhdimësi në UBT, këtij institucioni të arsimit të lartë në vend po i shtohen edhe mirënjohjet dhe vlerësimet vendore e ndërkombëtare për nivelin e lartë të zhvillimit në të gjitha fushat.

Vitin e kaluar, pas vlerësimit të ekspertëve të njohur ndërkombëtarë për një javë rresht, u konfirmua se UBT ka arritur nivelin e zhvillimit në shkallë të ekselencës. Sipas organizatës që bën vlerësimin për ekselencë në Evropë (EFQM), certifikimi i UBT-së për ekselencë është i

vetmi jo vetëm në Kosovë por në tërë rajonin e Ballkanit. Kjo dëshmon se, edhe kur funksionon në një shoqëri dhe shtet në tranzicion, është i mundur dizajni dhe menaxhimi i sistemeve moderne, duke respektuar plotësisht standardet më pozitive për cilësi, teknologji, menaxhim dhe lidhshmëri.

Çmimi për ekselencë tregon se UBT po rritet e po zhvillohet pandalshëm. Dëshmi për këtë janë edhe kënaqësia më e madhe të studentët, rezultatet më të mira në provime, programet e reja, proceset më efikase dhe eficiente, më shumë qendra profesionale, resurset dhe infrastruktura më moderne, laboratorët, literatura, metodat e reja të menaxhimit dhe të inovacionit, stafi më i shumtë dhe më i kualifikuar, strategjitë afatgjatë dhe shumëdimensionale, më shumë punë shkencore, publikime, më shumë ndërkombëtarizim, partneritete, më shumë mobilitet dhe internship,...

Të gjitha këto bëhen të mundura, përveç të tjerash, edhe me ndërtimin e hapësirave të reja në Kampusin Inovativ të UBT-së, i njohur tashmë edhe ndërkombëtarisht, me Inkubatorin e parë Virtual në vend, me përkrahje të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe të Bashkimit Evropian, me bashkëpunimet ndërkombëtare me institucione akademike, që ju kanë mundësuar shumë prej jush që të vazhdoni studimet dhe të fitoni grada shkencore e akademike.

Fokusimi në Cilësi dhe Inovacion është synimi i përhershëm i UBT-së. Për këtë po punojmë pandalshëm të gjithë, menaxhmenti, mësimdhënësit, studentët. Është rruga e vetme e ecjes përpara, në të cilën UBT e është lider, të cilën njeh mirë dhe e zhvillon pa dilema. UBT është shtëpia jonë dhe e juaja! Sukseset tona janë edhe tuajat, siç i konsiderojmë tonat të gjitha sukseset e Juaja. Shkalla e lartë e punësimit dhe ndërtimit të karrierës nga ana e juaj është një e dhënë që neve na bën krenarë. Vazhdojmë, bashkë, në këtë rrugë.

E ardhmja është e jona – e UBT-së dhe e juaja...

**UNIVERSITY EDUCATION
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY**
 AMERICAN EUROPEAN EDUCATION

EEE

INXHINIERI E ENERGJISË EFIÇIENTE
(ENERGY EFFICIENCY ENGINEERING - EEE)

Shkollë profesionale 2 vjeçare (120 kredi), me mundësi
vazhdimi në Bachelor 3 vjeçarë (180 kredi) në

INXHINIERINË E ENERGJISË
(ENERGY ENGINEERING)

TË VETMET PROGRAME TË AKREDITUARA NË KOSOVË

Recognised for excellence
4 star

info@ubt-uni.net +377 (0)44 541 400
www.ubt-uni.net

Në UBT i zhvilloi punimet konferenca “Ditët Austriake-Kosovare 2015”



Prishtinë, 1 mars. - “Ditët Austriake-Kosovare 2015” ishte konferenca dyditore ndërkombëtare, që i zhvilloi punimet në lokalet e UBT-së në Prishtinë dhe në të cilën morën pjesë përfaqësues nga qeveria austriake, institucione të tjera të këtij shtetit, si dhe përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Konferenca është organizuar nga UBT, në bashkëpunim me Asociacionin Austriak-Kosovar, Klubin Alpbach Kosovë dhe me mbështetje nga Ambasada e Austrisë në Prishtinë si dhe anëtarët e Shoqërisë austriake të Kosovës në Kosovë dhe akterët kyç austriakë që mbështesin Kosovën.

Ndër temat kryesore që u shtruan për diskutim gjatë sessionit të hapjes dhe gjatë dy ditëve të konferencës, ishin: E ardhmja evropiane e Kosovës; Përvojat e Austrisë si një shtet që shënon 20-vjetorin e anëtarësimit në BE; Sfi-

dat e Kosovës sot në rrugën drejt Bashkimit Evropian; E-Qeverisja si bazë për Qeverisje të Mirë; E-Qeverisja si bartëse e reformës në fokus në kujdesin shëndetësor; E-Arsimi si faktor kyç për reformimin e Arsimit në Kosovë; Bashkëpunimi ekonomik midis Austrisë dhe Kosovës, Reforma ekonomike në bazë të e-Qeverisë si faktor kyç për investime të mëtejshme të Austrisë në Kosovë; E-Qeverisja dhe bashkëpunimi në inovacion ndërmjet Austrisë dhe Kosovës, si faktor kyç për menaxhim urban dhe kadastër etj.

Në hapje të konferencës, rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, si dhe të gjithë bashkorganizatorët e kësaj konference, që ofron tema me shumë interes për opinionin kosovar dhe më gjerë.

Z. Hajrizi theksoi se Universiteti për Biznes dhe Teknologji ka nderin që të jetë nikoqir i Partneritetit Austriak-Kosovar, dhe e vlerësoi këtë konferencë si ngjarje të rëndësishme që ka për qëllim promovimin dhe implementimin e menaxhmentit të integruar.

Ai u shpreh se në Kosovë ka një dinamizëm të lartë, sistem të ri dhe një gjeneratë të re, ndërsa ndër pikat kryesore që theksoi si prioritet ishin teknologjia, globalizmi dhe resurset humane.

“Leadershipin do ta transformojmë në partneritet me vendet e Evropës”, tha ndër të tjera z.Hajrizi.

Ministri i Administratës Publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, z.Mahir Yağcılar, theksoi se institucionet dhe qytetarët e vendit tonë synojnë një Kosovë evropiane.

“Si Qeveri e Kosovës, si Ministri e Administratës Publike, jemi të gatshëm ta çojmë përpara përdorimin e teknologjisë informative, por edhe të krijojmë njerëz të cilët janë të gatshëm ta përdorin teknologjinë informative,



E-Qeverisjen, që ta ndërtojmë një Kosovë evropiane”, theksoi ministri Yağcilar.

Ai falënderoi organizatorët për organizimin e kësaj konference ndërkombëtare për qeverisje elektronike, me rëndësi të jashtëzakonshme për vendin, për avancimin dhe zhvillimin e qeverisjes elektronike në Kosovë.

“Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur të bëjë reformë të administratës publike dhe të avancojë qeverisjen elektronike, përmes proceseve administrative dhe digjitalizimit të këtyre proceseve, ku synohen shërbime më cilësore, përdorimi më efikas të ndërmarrjet publike, për procese më efikase dhe më të shpejta të qeverisjes. Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar dokumente strategjike dhe akte të tjera që ndihmojnë fushën elektronike të komunikimeve dhe shërbimeve elektronike. Në vitin 2008 është miratuar Strategjia për E-qeverisje dhe kemi filluar dhe do të vazhdojmë hartimin e strategjisë në periudhën e ardhshme 5-vjeçare, që është një hap i strategjisë dhe reformës së administratës publike dhe vazhdimin e strategjisë për inovacionin”, tha ndër të tjera ministri i Administratës Publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, z.Mahir Yağcilar.

Në vazhdim foli z.Christian Rupp, koordinator i Qeverisë së Austrisë për qeverisje elektronike. Ai e vlerësoi Kosovën si një vend me bazë të mirë të zhvillimit, ndërsa theksoi se UBT i ka kushtet dhe premisat për të qenë i suksesshëm.

Duke folur për zhvillimin e teknologjisë në përgjithësi, ai u shpreh se në këtë drejtim menaxhmenti luan rol të rëndësishëm. “Teknologjia është pjesë e vogël, mund të them 20 për qind dhe pjesa tjetër, 80 për qind, është ndryshimi i menaxhmentit. Për të qenë i suksesshëm duhet ndryshim i menaxhmentit, forcë ndryshuese (një menaxher i mirë) dhe siguri i informacioneve”, tha ai.

Ai u shpreh i kënaqur edhe me sistemin elektronik që ofron shërbimet elektronike. “Sektori publik dërgon dokumente zyrtare në mënyrë elektronike, çdo pyetje e përgjigje prej klientëve duhet ti kemi në formë elektronike.

Adriana Boersma: “Interneti u ka ndihmuar njerëzve në ndryshimin e botës”



Adriana Boersma, menaxhere e rrjetit të “Microsoftit” në mbi 20 shtete, pas fjalës në konferencën “Ditët Austriake-Kosovare 2015”, u përgjigj në disa pyetje për gazetën e studentëve “UBT News”

E pyetur sa kjo konferencë ka ndihmuar të rinjtë që ta kuptojnë rëndësinë dhe të mirat e rrjetit elektronik, ajo tha: “Para së gjithash mendoj se është një mundësi e madhe për studentët që të marrin pjesë dhe të kenë mundësi të shohin ide të reja nga vendet e jashtme. Studentët patën mundësi të mësojnë sadopak në lidhje me privatësinë, sigurinë, transparencën, që janë shumë të rëndësishme dhe krijimin e së ardhmes në Kosovë. Shpresoj se Microsofti mund të japë një platformë që të keni sukses në punën parë të mjedisit”.

“Unë mendoj se interneti ju ka ndihmuar njerëzve në ndryshimin e botës. Njerëzit, si për shembull studentët, e kanë më të lehtë dhe ata po e ndryshojnë botën, sepse e kanë një platformë të quajtur Internet dhe ajo po ndryshohet dita-ditës me ide të reja”, vijoi znj. Boersma. E pyetur lidhur me mundësitë që ofrohen për ruajtjen e të dhënave në serverë të kompanive të mëdha, jo u përgjigj: “Nuk ka nevojë të keni bazë të të dhënave, por ICLOUD ju ofron shërbime që të keni të dhëna dhe informacione të sigurt sikur sot që ju treguan përfaqësuesit e MICROSOFT-it. Nuk keni nevojë të brengoseni për gjërat që jeni të interesuar t’i mbani, t’i ruani dhe t’i arrini. Nuk keni nevojë të brengoseni me teknologjinë informative. Ju e dini se në mënyrë të lehtë dhe të thjeshtë mund të jeni në gjendje që me Microsoft ICLOUD të mbronin të dhënat. Ju mund të jeni produktivë duke përdorur platformën e Microsoftit dhe të filloni të punoni me ide të reja”.



Pranojmë vetëm faturat elektronike, jo aty të shtypura dhe kjo është bazë ligjore”, tha ndër të tjera z. Rupp. Kujtim Gashi nga Agjencia Kosovare për Shoqëri të Informacionit, pasi foli për bazën ligjore që mbulon këtë fushë, të miratuar gjatë vitit 2013 dhe 2014, theksoi se është krijuar një bazë e mirë që edhe institucionet e Kosovës të ecin drejt modernizimit të sektorit publik.

“Dokumentet e rëndësishme strategjike të qeverisjes elektronike janë dokumente të cilat legjislativi i Kosovës dhe Qeveria i ka aprovuar si dokumente të rëndësishme në drejtim të zhvillimit të e-qeverisjes në Kosovë”, tha ai. Ai përmendi një varg ligjesh të miratuara, ndër të cilët veçoi Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, që është një ligj i rëndësishëm për këtë fushë dhe një dokument i me rëndësi të veçantë.

Z.Gashi theksoi në vijim se është duke u punuar në nxjerrjen e strategjisë së re, që do të shënojë përmirësim të dukshëm në këtë fushë.

Një mysafire e veçantë në konferencë ishte edhe Adriana Boersma, menaxhere e rrjetit të “Microsoftit” në mbi 20 shtete.

Fillimisht, znj. Boersma foli për rëndësinë e Microsoftit për jetën e njerëzve dhe qasje sa më të lehtë të të dhënave të shërbimeve online.

“Është nder të jem këtu. Kosova është një vend i bukur, me sfida dhe mundësi të mira për zhvillim në fusha të ndryshme. Pajisjet e reja teknologjike njerëzve u kanë ofruar lehtësim në ofrimin e shërbimeve elektronike. Studentëve u kanë ofruar mundësi dhe qasje në mësim-nxënie”, tha Adriana Boersma.

Ajo theksoi se teknologjia informative ka potencial të lartë në mbrojtjen e të dhënave, të sigurisë dhe të shërbimeve të ICLOUD. Sipas saj, Microsoft mundëson arritjen e objektivave, kalimin e sfidave dhe vështirësive, me efikasitet më të madhe të ofrimit të shërbimeve elektronike.

Znj. Boersma e falënderoi dhe e mbështeti Presidentit e UBT-së për këtë partneritet në fushën e teknologjisë dhe zhvillimit të saj dhe shfaqti dëshirën që të ndihmojë sa i përket këtij sektori të shërbimeve dhe të dhënave.

“Dua t’ju ndihmojmë edhe juve që të krijoni mundësi të mira në sferën dhe sektorin e shërbimeve publike dhe elektronike”, tha ndër të tjera zonja Adriana Boersma. Ndërsa, Mentor Hoxhaj nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, theksoi ndër të tjera se një ndër detyrat kryesore të kësaj agjencie është gjetja e balancit mes transparencës dhe privatësisë.

Kjo, tha ai, është një sfidë e vazhdueshme, e cila ka ardhur edhe me zhvillimin e teknologjisë informative ashtu edhe të transparencës që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes.

“Gjetja e këtij balanci është një sfidë e vazhdueshme. Jemi duke tentuar që ta gjejmë dhe jemi duke punuar në këtë drejtim. Për të kuptuar më mirë sfidat në tërësi dhe mundësitë të cilat i kemi së bashku, duhet të kuptojmë edhe në cilën botë jemi duke jetuar. Jemi duke jetuar në botën e rrjetëzuar, jemi të digjitalizuar tërësisht me identitetet tona, lokacionet e veprimt, shoqërimin, të gjitha të ruajtura në BIT dhe BYTE. Sasia e informacioneve të gjeneruara brenda ditës është një sasi jashtëzakonisht e madhe. Gjersa në vitin 2013 janë gjeneruar 4 trilionë gigabajt, në vitin 2014 kemi dyfishim të kësaj shifre, 8 trilionë gigabajt”, tha ndër të tjera z.Hoxhaj.



Sherif Gosalci

Korrektësia në vlerësim dhe nxitja e zhvillimit të ligjëratave përmes debatit - faktor në arritjen e rezultateve

“Angazhimi, serioziteti dhe përvoja profesionale dhe jetësore kanë qenë shtytësit kryesorë për arritjen e rezultateve, gjithashtu korrektësia në vlerësim dhe nxitja e zhvillimit të ligjëratave përmes debatit nga personeli akademik ishin faktorë në arritjen e këtyre rezultateve”, thotë Sherif Gosalci, i cili studimet në Fakultetin e Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë i ka përfunduar me notën 9.97

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Gosalci: Bazuar në informacionet përmes mediave si dhe nga studentët që kanë përfunduar studimet dhe atyre që janë duke studiuar, kam vendosur t'i bashkohem UBT-së.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Gosalci: Është interesante se të gjitha lëndët në drejtimin që kemi ndjekur kanë qenë shumë interesante dhe është vështirë që të bësh diferencën, meqë ligjëratat na janë ofruar nga profesorë eminentë.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Gosalci: Padyshim se gjatë studimeve bachelor kemi pasur ngjarje të shumta dhe të veçanta andaj unë nuk do të mund të selektoja ndonjërin nga to si më e rëndësishmja.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Gosalci: Përfitimet janë të mëdha dhe vlerësuesi më i mirë është ngritja e performancës në vendin e punës ku veprojmë.

UBT Alumni: A keni përfituar nga mundësitë që ofron UBT për udhëtime studimore, studime jashtë vendit përmes UBT-së, internship apo forma të tjera të angazhimit?

Gosalci: Meqë jemi në marrëdhënie të rregullta pune ne nuk kemi pasur mundësi të jemi pjesë e udhëtimeve studimore edhe pse një mundësi e tillë na është ofruar.

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Gosalci: Angazhimi, serioziteti dhe përvoja profesionale

dhe jetësore kanë qenë shtytësit kryesorë për arritjen e rezultateve, gjithashtu korrektësia në vlerësim dhe nxitja e zhvillimit të ligjëratave përmes debatit nga personeli akademik ishin faktorë në arritjen e këtyre rezultateve.

UBT Alumni: A jeni duke punuar pas studimeve dhe ku?

Gosalci: Isha duke punuar edhe para studimeve, e po ashtu edhe pas studimeve punoj si parashikues meteorologjik aeronautik në Divizionin Meteorologjik – ANP-Kontrolli Ajror “Adem Jashari”, gjegjësisht jam në pozitën e Menaxherit të këtij Divizioni. Shprehur shkurtimisht, ofrojmë për ekuipazhet, fluturaket si dhe shfrytëzuesit e tjerë aeronautikë, informacione dhe produkte meteorologjike aeronautike me qëllim të realizimit të operimeve të sigurta aeronautike.

UBT Alumni: A jeni duke vazhduar studimet?

Gosalci: Jam duke vazhduar studimet master në drejtimin e ri të akredituar në UBT, në “Politika Publike dhe Menaxhment” dhe jam jashtëzakonisht i kënaqur me ecurinë e gjertanishme të këtyre studimeve.

UBT Alumni: Cila është porosia Juaj për studentët e UBT-së?

Gosalci: Unë do të porosisja të gjithë studentët e UBT-së, të kenë përkushtimin maksimal në studime, sepse vetëm përmes edukimit cilësorë dhe adekuat mund të arrijmë përmbushjen e qëllimeve tona në sferën personale dhe ngritjen e mirëqenies në nivel kombëtar, duke synuar arritjen e kombeve të zhvilluara.

UBT Alumni: Cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

Gosalci: Synojmë që vazhdimisht gjatë studimeve master por edhe pas përfundimit të kontribuojmë në dobi të familjes, ndërmarrjes ku punoj dhe shoqërisë sonë si tërësi duke shfrytëzuar potencialin, dijen e fituar dhe praktikën nga UBT si një tempull i diturisë.



Petrit Mehmeti

Përvojat e fituara në UBT më kanë shërbyer shumë në ngritjen time profesionale

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Mehmeti: Në vitin 1998 kam qenë i regjistruar në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës ku pata përfunduar edhe vitin e parë, por për shkak të gjendjes së vështirë që mbretëronte asokohe në Kosovë dhe më pas taj fillimit të luftës, mu desh t'i ndërpres studimet. Pas

luftës u punësova në Aeroport dhe për shkak të obligimeve të shumta që kisha atje nuk m'u dha mundësia që t'i vazhdoja studimet e lëna. Tek në vitin 2011 m'u krijuan kushtet t'i vazhdoja studimet, por për shkak të burokracisë që është e instaluar në Universitetin Publik të Prishtinës vendosa t'i tërheq dokumentet nga atje dhe me

rekomandimin e disa shokëve vendosa që të regjistrohem në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), ku edhe i anulova provimet e dhëna më parë dhe fillova prapë nga fillimi. Rekomandimet e shokëve se UBT është një Universitet serioz, ku aplikon kritere dhe ka një staf të kualifikuar si ndërkombëtarë ashtu edhe vendas, ishin shtytja kryesore që të regjistrohem në këtë Universitet.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Mehmeti: Është vështirë të veçoj ndonjë lëndë sepse secila ka pasur rëndësinë e saj në formësimin dhe përgatitjen profesionale, por mund të them që lëndët që më kanë lënë më shumë mbresa janë lënda e Makroekonomisë, Kontabiliteti Menaxherial, Tregtia Ndërkombëtare, Menaxhmenti Financiar.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Mehmeti: Studimi në këtë Universitet ka qenë një eksperiencë e këndshme por edhe sfiduese. Së pari ky Universitet u ofron studentëve shërbime dhe infrastrukturë të nevojshme që lidhen drejtpërdrejt me sigurimin e cilësisë së studimeve, të jetës sociale, duke filluar që nga përkudësja dhe mbikëqyrja akademike, asistencë e personelit administrativ, vënia në dispozicion e një infrastrukture bashkëkohore si biblioteka, kompjuterë etj. Gjithashtu mësimdhënia në këtë Universitet përqendrohet në njohuritë më të mira bashkëkohore, në programe e tekste mësimore moderne, në metoda të mësimdhënies cilësore, që e bëjnë studentin pjesë aktive të procesit mësimor.

Ligjërimi i shumë profesorëve eminentë nga bota e bënë këtë Universitet të veçantë dhe gjithashtu dëshmon seriozitetin dhe përkushtimin në përgatitjen e kuadrove për të qenë në hap me zhvillimet e përgjithshme globale. Qasja në përvojat e Universiteteve gjegjësisht përvojat e profesorëve të vendeve të ndryshme paraqet një vlerë të shtuar për studentët dhe përfitimi nga këto përvoja ka qenë shumë i rëndësishëm për mua. Bartja e praktikave nga vende të ndryshme të botës ka ndikuar në ngritjen profesionale dhe përgatitjen për t'u përgjigjur kërkesave të përditshme. Kur kihet parasysh se të gjithë këta profesorë vijnë nga vende të ndryshme me një zhvillim të hovshëm ekonomik-teknologjik, praktikën e tyre kanë një rol të veçantë për ne në zhvillimin e resurseve njerëzore, teknologjike etj.

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Mehmeti: Një nga faktorët kryesorë që ka ndikuar në arrijtjen e rezultateve të mia ka qenë padyshim puna e madhe, mësimdhënia cilësore dhe mbështetja e shumë profesorëve që duke ndarë praktikën profesionale me studentët kanë qenë frymëzim për t'u angazhuar më tepër gjatë studimeve. Gjithashtu edhe serioziteti, angazhimi personal dhe përkrahja familjare kanë ndikuar në finalizimin me sukses të këtyre studimeve.

UBT Alumni: A jeni duke punuar pas studimeve dhe ku?

Mehmeti: Tash e 15 vite punoj në Agjencinë e Shërbimeve të Navigimit Ajror në Aeroportin e Prishtinës si parashikues meteorologjik. Në vitin 2000 kam përfunduar trajnimin në "Met Office College" të Britanisë së Madhe për vrojtues meteorologjik, ndërsa nga viti 2002-2004 shkollimin në të njëjtin kolegji për parashikues aeronautik meteorologjik. Gjithashtu, kam përfunduar edhe shumë

trajnime të tjera në shtete të ndryshme të Evropës që ndërlidhen me aviacion, por vlen të cekem një varg trajnimesh në "Eurocontrol" të Luksemburgut që kanë të bëjnë me sigurinë e fluturimeve dhe hetimin e incidenteve dhe ndodhive ku kam marrë edhe titullin ekspert i sigurisë dhe hetues i incidenteve dhe aksidenteve aeronautike.

Të jesh pjesë e një kompanie me rëndësi të veçantë përveç punëve të rëndomta ditore përmban në vete edhe sfida tjera. Përvojat e fituara nga UBT përgjatë gjithë studimeve më kanë shërbyer shumë në ngritjen time profesionale dhe në vazhdimësi këto përvoja tentoj ti praktikoj edhe në vendin ku punoj, konkretisht në menaxhimin e projekteve, burimeve njerëzore dhe në përgjithësi menaxhimin e punëve ditore.

UBT Alumni: A jeni duke vazhduar studimet?

Mehmeti: Aktualisht jam duke i vazhduar studimet master në Fakultetin për Politikë Publike dhe Menaxhim në UBT. Meqë punoj në një institucion publik dhe pasi që është program i ri në Kosovë, më ka ngjall kureshtje që të studioj edhe këtë fushë. Problematikat e menaxhimit të politikave publike janë fusha jo shumë të adresuara dhe të eksploruara në vendin tonë. Me përfitimet nga këto studime master shpresoj që do të jap kontribut shtesë në vendin ku punoj dhe si rrjedhojë do të reflektoj edhe në ngritjen e efikasitetit dhe eficiencës në detyrat e përditshme.

UBT Alumni: Cila është porosia juaj për studentët e UBT-së?

Mehmeti: Porosia për studentët e UBT-së është që të angazhohen maksimalisht dhe të shfrytëzojnë mundësitë e mëdha që u ofron ky Universitet. Sot jetojmë në një epokë të zhvillimeve të mëdha teknologjike e shkencore dhe ku kemi një konkurrencë të jashtëzakonshme në tregun e punës, andaj duhet t'i shfrytëzojnë të gjitha këto mundësi që u ofrohen në mënyrë që të jenë sa më të përgatitur për t'u përballur me këto sfida.

UBT Alumni: Cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

Mehmeti: Aktualisht nuk kam ndonjë plan specifik. Më vjen në mendje prioriteti i imi është përfundimi me sukses i studimeve master.

SYRI



Hekuran Popaj

Mjafton vullneti dhe dëshira, suksesi arrihet në UBT

“Në UBT diploma ka vlerë shumë, por rëndësi të madhe ka dija dhe njohuritë që studenti i përfiton gjatë kohës së studimit në këtë universitet. Besoj se përgjatë studimeve kam arritur ta njohë shumë mirë fushën e ekonomisë duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me ligjëruesit e UBT-së”, thotë Hekuran Popaj, i diplomuar në MBE në UBT dhe që vazhdon studimet master në të njëjtin drejtim

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Popaj: Në kohën sa isha maturant, sfida kryesore me të cilën përballesha ishte se ku do të orientoheja për studime bachelor. Kisha mundësi që si nxënës i shkëlqyer i Kolegjit “Mehmet Akif”, të përfitoja bursa jashtë vendit, në shtete si Shqipëria, Maqedonia, Turqia, Zvicra etj. Pasi isha afër të përzgjidhja njërin nga këto vende, dëgjova se kishte një Universitet në Prishtinë, i cili ishte ndër më të mirët në vend. Pas vizitës që bëra në UBT, në atë kohë pashë kushtet fizike të universitetit dhe mora informacione bazë për regjistrim. Por çka realisht më bëri ta zgjedhja UBT, ishte emri i mirë dhe cilësia që e karakterizonte në publik. Kjo më bëri të ndihesha njëjtë si të studioja në Evropë e si në UBT, në Kosovë.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Popaj: Gjatë studimeve në UBT në programin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, kishte lëndë të ndryshme dhe shumë interesante. Disa nga to do t'i veçoja për nga kureshtja që më nxisnin për t'i studiuar. E ato ishin: Kontabiliteti Financiar dhe Menaxherial, Makro dhe Mikroekonomia, Metodat Statistikore, Menaxhimi Operacional etj. Ishte ndjenjë e mirë të jesh i suksesshëm në lëndë të ndryshme, duke pasur mundësi të marrësh më të mirën nga ligjëruesit e UBT-së, ku mundësohej një proaktivitet i shkëlqyer.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Popaj: Përveç mundësisë për të studiuar në UBT në kushte të mira dhe të përshtatshme, kishte hapësira për të kontribuar edhe në shumë aktivitete shoqërore dhe akademike. Gjate tri viteve të studimeve në nivelin bachelor në UBT, kam pasur nderin dhe përgjegjësinë të jem përfaqësues i studenteve në të gjitha nivelet. Duke filluar nga lideri i grupit, pastaj i fakultetit MBE dhe deri te titulli President i Organizatës Studentore të UBT-së me të cilin krenohem dhe besoj që e kam ushtruar me sukses. Ishte privilegj i madh të përfaqësoja studentët më të mirë në vend, aq sa ishte detyrë e vështirë dhe përgjegjësi e lartë. Por, mbi të gjitha, ishte nder, të cilin e respektova dhe dhashë kontributin tim së bashku me të gjithë delegatët e zgjedhur në Organizatën Studentore të UBT-së. Organizata ishte e orientuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në studime, përfaqësimin sa më të



mirë të kërkesave të studentëve, organizimin e debateve mbi tema të ndryshme, organizimin e rekreacioneve dhe ahengjeve të vogla etj. Së bashku me delegatët e Organizatës së UBT-së punuam në këtë drejtim dhe përmbyllëm ciklin tonë të punës, i cili ishte njëvjeçar. Besoj që do të përmendemi për të mirë!

Gjatë gjithë kohës së studimeve arrita të shohë se sa Presidenti i UBT-së, z.Edmond Hajrizi bënte për studentët dhe punonte me ta në zhvillimin e mëtutjeshëm të Universitetit. Kishim përkrahjen e vazhdueshme të tij si Organizatë dhe si studentë në përgjithësi.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Popaj: UBT është zhvilluar shumë viteve të fundit. Kjo si arsye e mundësisë që jep për të studiuar në shumë fakultete.

Në programin MBE, kam arritur të përfitoj njohuri të shumta dhe të jem në hap me zhvillimet e kohës në ekonomi.

Shpresoj që të gjitha njohuritë e fushës ku kam studiuar t'i përdori me po aq sukses në praktikë sa kam pasur në aspektin teorik.

Duket lehtë të thuhet tani, por sakrifica të shumta ka

përshkuar secili nga kolegët e mi dhe unë po ashtu që të arrijmë të diplomojmë në UBT.

Në UBT diploma ka vlerë shumë, por rëndësi të madhe ka dija dhe njohuritë që studenti i përfiton gjatë kohës së studimit në këtë universitet. Besoj se përgjatë studimeve kam arritur ta njohë shumë mirë fushën e ekonomisë duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me ligjëruesit e UBT-së.

UBT Alumni: A keni përfituar nga mundësitë që ofron UBT për udhëtime studimore, studime jashtë vendit përmes UBT-së, internship apo forma të tjera të angazhimit?

Popaj: Performanca e mirë në studimeve shpërblehej me bursa. Përgjatë tri viteve të studimit kam qenë përfitues i bursës më të madhe brenda UBT-së dhe nga UBT-ja, e cila ka qenë në shumë prej 25 për qind e shumës total të regjistrimit.

Nuk kam qenë përfitues i bursave jashtë vendit, pasi nuk kam aplikuar. Shkaku kryesor kanë qenë obligimet e punës dhe ato familjare.

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Popaj: Me trendet çdoherë në lëvizje dhe ndryshimet e mëdha inovative në botë dhe në vendin tonë, vendosa ti përcjell dhe të jem pjesë e zhvillimit të tyre.

Si fillim përcaktova drejtimin tim, aty ku e ndjeja veten më të fortë dhe ku mund të kontribuoja në të ardhmen.

Duke qenë që ekonomia është një ndër sektorët më të rëndësishëm të një shteti apo shoqërie, vendosa të studioja këtë drejtim. Zgjodha UBT-në, këtë institucion të arsimit të lartë për t'u specializuar në këtë fushë dhe për t'u zhvilluar si ekonomist.

Nëse zgjedh të studiosh diçka që do dhe diçka që e bën me shumë dëshirë, atëherë suksesi nuk do të mungojë. Kështu besoj unë.

Kam arritur të ambientohem shumë mirë në sistemin e edukimit në UBT, pasi që stafi akademik dhe menaxherial i këtij institucioni kanë arritur të jenë gjatë gjithë kohës në shërbimin e studentëve.

Po ashtu gjatë kohës së studimeve kam pasur mundësi të krijoj raporte të mira me

kolegë prej shumë fakulteteve të tjera.

Duke qenë i qartë në përcaktimin e vizionit dhe misionit tim, për arritjet e mia personale, besoj se pata mundësi të arrija, sukses pavarësisht pengesave që hasa gjatë rrugës.

Mjafton vullneti dhe dëshira, suksesi arrihet në UBT!

UBT Alumni: Me çfarë jeni duke u marrë aktualisht?

Popaj: Pas përfundimit të studimeve bachelor në UBT, jam regjistruar për studime postdiplomike master në MBE dhe paralelisht kam filluar të punoj në kompaninë familjare si menaxher kryesor i Qendrës Tregtare, e cila gjendet në Xërxe të Rahovecit dhe është e vetmja në atë regjion.

Muharrem Cani

Rezultatet e mira duan shumë punë dhe përkushtim

“Për të arritur rezultate të mira duhet një punë dhe përkushtim i madh, mirëpo duhet të jemi mirënjohës edhe për të gjithë profesorët dhe asistentët, të cilët nuk kanë hezitur asnjëherë që të na ndihmojnë për çdo paqartësi, duke i ndarë njohuritë e tyre bashkë me ne, duke na ofruar materiale, literaturë të mjaftueshme dhe, falë përkushtimit të tyre dhe tonin, kemi arritur të tregojmë rezultat të kënaqshëm”. Kështu shprehet Muharrem Cani, i cili pas përfundimit të studimeve bachelor në Fakultetin e Arkitekturës në UBT është duke i vazhduar studimet master në të njëjtin fakultet.

“Jam regjistruar prapë në UBT për studimet master në po të njëjtin drejtim, pra Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor ku tani, përveç disa profesorëve që i kemi pasur edhe më herët, ka edhe profesorë ligjërues nga universitetet e ndryshme të Evropës”, vijon ai.

Teksa përkujton fillimin e studimeve, z.Cani thotë se ndikim për t'u regjistruar në këtë degë të studimeve në UBT, pas dëshirës së tij për të studiuar në arkitekturës, kanë pasur edhe kolegë të tij, që tashmë kishin nisur studimet në UBT, që i kanë folur për mundësitë e mira për studime që ofrohen në këtë universitet.

Ai thotë se lënda që ka pasur më për qejfi është ajo e Konstruksioneve Arkitektonike, ndërsa thekson se gjatë periudhës së studimeve, për studentët kanë qenë shumë të rëndësishme vizitat nëpër fabrika të ndryshme, vizita në disa qyteteve evropiane, të cilat kanë qenë me rëndësi arkitektonike, vizita në panaire të materialeve në

Turqi, pastaj punëtoria e realizuar me studentët e Universitetit “Mimar Sinan” në Stamboll e të tjera.


Gjithashtu, ai shprehet se nga programet e studimit në UBT kemi përfituar mjaft shumë dhe është i kënaqur nga ajo që u është ofruar, me ligjëratat, ushtrimet, konsultimet, me kontributin që e kanë dhënë profesorët dhe asistentët për studentët.

Z.Cani, si edhe gjatë kohës së studimeve, vazhdon të punojë në qytetin e Ferizajt dhe në rrethinë, në kuadër të një ndërmarrjeje të ndërtimtarisë.

“Sigurisht se pas studimeve, aftësitë e mia janë më të avancuara se më parë, si rrjedhojë edhe kualiteti i punimeve është më i lartë”, shprehet ai.

Nisur nga kjo, ai ka një porosi për studentët e rinj.

“Punoni sa më shume, bashkëpunoni ndihmoheni njëri-tjetrit në mësim, shfrytëzoni të gjitha mundësitë që u ofrohen për studime sa më të mira dhe suksesi nuk do të mungojë”.



Ismet Gosalci

Gara bëhet për dije, jo për nota!

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Gosalci: Studimet pranë UBT-së nuk i kam nisur rastësisht, pasi dëshira për të studiuar te unë nuk është shuar edhe pas një pauze mbi 20-vjeçare pas kryerjes së shkollës së mesme.

Pas kthimit nga eksodi, ku kam punuar punë të ndryshme në ndërtimtari mes viteve 1993-2001, jam inkuadruar menjëherë në marrëdhënie pune dhe pas dy vite pune në një Organizatë Humanitare kam dhënë kontributin tim si çdo qytetar i devotshëm i Kosovës. Aty kam hasur për herë të parë në probleme të natyrës së shkollimit dhe aty i kam premtuar vetës se duhet të investoj në rastin e parë që do të më jepej në shkollimin tim.

Mirëpo ky premtim i imi u shty për një kohë pas krijimit të familjes pasi të ardhurat e mia nuk më premtinin për një investim shtesë.

Këtë ëndërr dhe premtim e realizova vetëm pasi u inkuadrova në kompaninë private të sigurimit fizik "Balkan International" ku punoj në pozitën oficer personeli. Në vitin 2011 m'u dha mundësia që të kem informatat e para për UBT-në dhe aty për aty vendosa t'i bashkëngjitem kësaj armate të studentëve të etshëm për dije dhe shtegtim drejt horizonteve të reja.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Gosalci: Në UBT kam studiuar shkencat e Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë. Është për t'u përshëndetur niveli i përgatitjes profesionale të mësimdhënësve gjë që më ka ndihmuar shumë që unë krahas punës që punoj, të kem mundësinë të studioj në një ambient mësimi dhe garimi mes kolegëve, ku ka dominuar vrapimi pas shfletimit të literaturës vendase dhe të huaj që nuk ka qenë mungesë, si dhe ligjëratave e ushtrimeve nga profesorët e asistentët e UBT-së.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Gosalci: Ngjarje të veçantë gjatë studimeve që mund të ndaj me lexuesit e "Alumnit" do të veçoja ligjëratat e prof. Nazmi Zeqirit, i cili me aq përkushtim dhe zell i përgatit ligjëratat e tij. Në këtë rangim hyn edhe prof. Mentor Geci. Që të dy këta profesorë, si dhe asistentet e tyre, janë aq të përgatitur, sa që vështirë studenti aktiv dhe punëtorë të dështojë. Me fjalë të tjera, zelli dhe angazhimi i studentit në UBT vlerësohet krahas rezultateve nga provimet që u nënshtrohen.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Gosalci: Nga programet që kemi pasur gjatë studimeve në UBT, më së shumti përfitim kam pasur nga lëmia e Statistikës, pasi këtë e kam praktikuar në profesionin tim në kompaninë ku punoj.

UBT Alumni: A keni përfituar nga mundësitë që ofron UBT për udhëtime studimore, studime jashtë vendit përmes UBT-së, internship apo forma të tjera të angazhimit?

Gosalci: Përfitim kam pasur si bursist, pasi është bërë

praktikë që studentët e dalluar të kenë mundësinë e aplikimit për bursë.

Mendoj se kjo praktikë duhet edhe më tutje të vazhdojë në UBT pasi stimulon studentët në arritjen e rezultateve sa më të mira gjatë studimeve.

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Gosalci: Angazhimi im personal dhe puna ekipore me kolegët Sherif Gosalcin dhe Petrit Mehmetin ka bërë që ne të bëjmë gara se kush po mëson më shumë, kush ka shfletuar dhe studiuar literaturë të nevojshme dhe të rekomanduar, ashtu që e tërë kjo është gërshetuar me sukses në provime. Te ne të tre, periudha e studimit dhe debatit nga secili provim që e kemi kryer nuk ka përfunduar me notimin nga profesori, por vazhdon edhe sot e kësaj dite edhe pse programin e studimit në nivel Master e kemi tjetër, prapëseprapë temat nga MBE zënë vend në debatet tona.

UBT Alumni: Çfarë pune bëni aktualisht?

Gosalci: Në kompaninë private të sigurimit fizik "Balkan International" së pari punova si roje, pastaj si shef ndërimi, më vonë si shef sigurimi, dhe mes viteve 2003-2004 si radio-operator. Nga viti 2004 u avancova në pozitën oficer personeli ku edhe më tutje vazhdoj të ushtrtoj të njëjtin funksion. Në një kolektiv të shëndoshë ku marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe kolegiale janë të shkëlqyera kam të bëj me dokumentacionin e punëtorëve tanë (mbi 700 sish) dhe përcjelljen e tyre prej punësimit, certifikimit, licencimit, vazhdimet të kontratave të tyre dhe çdo lloj pune administrative që i përket personelit të një kompanie prestigjioze, si për nga shërbimi ndaj klientëve po ashtu edhe për nga brendi që ka ndërtuar, siç është "Balkan International".

UBT Alumni: A jeni duke vazhduar studimet?

Gosalci: Studimet MASTER këtë vit jam duke i vazhduar në UBT, në programin e Politikave Publike dhe Menaxhimit. Me akreditimin e programit "Politika Publike dhe Menaxhim" anë UBT dhe pas konsultimit me profesorët dhe rektorin e UBT-së, mora këshilla se këtu mundem më së shumti të kontribuoj pasi aty ku punoj jam pjesë e menaxhmentit dhe se aty mund të jap ndihmën më të madhe pasi të diplomoj Master. Ky program premtin se të gjithë ata që punojnë në Administratë e Menaxhment kanë mundësinë të përmirësojnë punën dhe menaxhimin e tyre dhe të tjerëve me aplikimin e metodave të reja që do mësojnë gjatë studimeve Master.

Nga ky program sa më shumë që po mësoj sot, aq më shumë po e zbuloj se sa i paditur paskam qenë dje.



Afrim Bajraktari

Njohuritë e fituara në UBT mund të aplikohen suksesshëm në biznes për të krijuar avantazh konkurrues

Posa kam kuptuar se UBT ofron programin e studimit në Menaxhimin e Mekatronikës, kam kontaktuar me dekanin e këtij fakulteti, dhe nga prezantimi që më është bërë, nga relacioni i drejtimin me atë që isha duke e studiuar, nga informacionet që i hulumtova në internet për këtë drejtim si dhe nga fakti se UBT vlerësohej mirë nga disa shokë që kishin studiuar më herët, vendosa të regjistrohem në UBT në këtë drejtim, i cili më pëlqen jashtëzakonisht shumë", thotë Bajraktari

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Bajraktari: Unë kam studiuar edhe në Universitetin e Prishtinës, pastaj kam qenë edhe në Universitetin Teknik të Mynihut si dhe në IVY Tech në Muncie/Indiana në Amerikë. Duke u bazuar në këtë përvojë në disa universitete, mendoj se mund të jap një vlerësim më real dhe më praktik sa i përket krahasimit të cilësisë së studimit. Posa kam kuptuar se UBT ofron programin e studimit në Menaxhimin e Mekatronikës, kam kontaktuar me dekanin e këtij fakulteti, dhe nga prezantimi që më është bërë, nga relacioni i drejtimin me atë që isha duke e studiuar, nga informacionet që i hulumtova në internet për këtë drejtim si dhe nga fakti se UBT vlerësohej mirë nga disa shokë që kishin studiuar më herët, vendosa të regjistrohem në UBT në këtë drejtim, i cili më pëlqen jashtëzakonisht shumë. Për më tepër kjo fushë e studimit në fakt nuk ofrohet nga ndonjë koleg apo universitet tjetër, dhe ishte në fakt një lidhje atraktive në mes të menaxhmentit dhe teknologjisë, dhe të gjitha këto kanë ndikuar që unë të studioj në këtë fakultet dhe në UBT.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Bajraktari: Pothuajse të gjitha lëndët nga Mekatronika. Do t'i veçoja: Inteligjencën Artificiale, Menaxhimi Strategjik dhe Ndërmarrësia, Menaxhimi i Inxhinierisë, Trendët në Teknologji, Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit, Automatizimi i Prodhimeve, Kreativiteti dhe aftësia e të mësuarit.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Bajraktari: Nuk do ta veçoja ndonjë prej tyre pasi ka pas shumë ngjarje të rëndësishme, secila me karakteristika rëndësie të veçantë të cilat nuk mund të rangohen e të krahasohen në prioritete. Ka shumë ngjarje që janë ofruar nga UBT por edhe ngjarje simultane nga institucione të tjera.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Bajraktari: Përfitimi që vlen të theksohet qëndron në faktin se shumë profesorë të cilët ligjërojnë në UBT vijnë nga universitete evropiane, kjo nënkupton se niveli i ligjërimit ka qenë pothuajse ekuivalent me nivelin në ato institucione prej nga vijnë. Gjithashtu mundësia e konsultimeve dhe interaksioni ligjërues-student është në nivel të kënaqshëm. Pjesa më e madhe e temave në ligjëratat ka qenë bashkëkohore, dhe kjo natyrisht ka pasur efekt pozitiv motivues duke ndikuar kështu edhe në nivelin e përfitimit të njohurive akademike nga programi përkatës.

Përgjithësisht mendoj se në UBT ofrohet mundësia shumë e mirë për ata studentë të interesuar për dije. Gjithsesi, duhet punuar vazhdimisht në ngritjen e kualitetit, e padyshim kjo

vlen për të gjitha institucionet.

UBT Alumni: A keni përfituar nga mundësitë që ofron UBT për udhëtime studimore, studime jashtë vendit përmes UBT-së, internship apo forma të tjera të angazhimit?


Bajraktari: Jo, pasi nuk kam aplikuar në ndonjë program, por, kam qenë pjesëmarrës në disa programe të ndryshme ndërkombëtare që ofrohen për studentë. Programe të tilla ofrohen për studentë të të gjitha institucioneve bartëse të edukimit të lartë universitar të akredituara private dhe publike, varësisht nga kualiteti i aplikimit dhe pjesëmarrja në aktivitete ekstrakurrikulare para aplikimit. Mundësi të tilla ofrohen shumë, dhe do t'i inkurajoja studentët të aplikojnë në këto programe në nivel nacional dhe internacional. Përvoja nga to është mjaftë e rëndësishme për karrierë akademike dhe profesionale.

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Bajraktari: Ka shumë faktorë që ndikojnë në rezultate shumë të mira, prej tyre më të rëndësishme mendoj se janë: angazhimi, persistenca, vijimi i rregullt i ligjëratave dhe aktiviteteve relevante që organizohen nga institucioni, shfrytëzimi i informacionit bashkëkohor nga burime kredibile në internet, dhe njëri ndër faktorët më të rëndësishëm është që ta duash shumë dhe ta kesh pasion drejtimin apo fushës e zgjedhur për studim.

UBT Alumni: A jeni duke punuar pas studimeve dhe ku?

Bajraktari: Po, jam duke punuar tani. Kam punuar edhe gjatë kohës sa kam qenë duke studiuar. Dhe do t'i rekomandoja studentët aktualë që krahas studimeve të kryejnë edhe ndonjë praktikë relevante me llojin e studimit që e zgjedhin ose ndonjë punë me orar të shkurtër, pasi kjo do t'i ndihmojë ta konkretizojnë qasjen teorike. Pra, është shumë me rëndësi puna apo praktika më qenë në linjë të njëjtë me studimet.



UBT Alumni: Çfarë pune bëni? Ju lutemi të na jepni sa më shumë detaje për dërmarrjen/institucionin ku punoni, pozicionin tuaj, rezultatet dhe çdo detaj që mund të jetë me interes.

Bajraktari: Unë e kam themeluar një biznes individual pasi kam ndjekur disa trajnime për ndërmarrësi dhe aspektet relevante biznesore. Kam përfutur mbështetje financiare nga BiD Network, në fakt pasi kam prezantuar planin e biznesit dhe strategjinë konceptuale biznesore në një garë prej shumë biznes planeve të paraqitura, jam shpërblyer me vendin e parë. Ky çmim ka qenë mjaft motivues dhe mbështetje e madhe.

Nga i njëjti institucion kam përfutur edhe një udhëtim në Afrikë për të marrë pjesë në një ngjarje "Growing SMEs East Africa conference", gjatë së cilës kemi prezantuar para investitorëve biznes planet tona pasi paraprakisht jemi trajnuar nga ekspertë. Kjo ka qenë një ngjarje mjaft e rëndësishme, biznes planin tim e kanë vlerësuar shumë pozitivisht, por risku kyç që i pengonte pothuajse të gjithë investitorët ishte jostabiliteti politik në Kosovë dhe çështja e sigurisë.

Pastaj kam përfutur grant nga USAID në kuadër të programit për mbështetjen e NVM-ve në Kosovë. Kam marrë një çmim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë "Best business idea 2012".

E kam fituar një bursë për të studiuar në Amerikë nga Këshilli Amerikan, programi KITE si mbështetje për biznesin tim. Njohuritë nga ky program më kanë ndihmuar shumë me njohuri të reja në fushën e strategjisë së marketingut, po ashtu, kam analizuar modele biznesore, produkte, shërbime dhe qasje unike biznesore të firmave atje, pjesë nga të cilat i kam implementuar dhe planifikojë t'i adoptoj në biznesin tim në planin afatshkurtër

dhe afatmesëm.

Trajnimet ekstrakurrikulare që lidhen ekskluzivisht me ndërmarrësin më kanë ndihmuar shumë dhe do t'i rekomandoja edhe për studentët e tjerë, por edhe lëndët në UBT janë mjaft të rëndësishme dhe njohuritë e përfutura nga to mund të aplikohen suksesshëm në biznes për të krijuar avantazh konkurrues. Në këtë kontekst, vlen të përmendet Menaxhimi Strategjik dhe Ndërmarrësia, dhe do ta rekomandoja për të gjithë studentët, por, edhe lëndët e tjera janë të rëndësishme, sa më shumë që lidhet një subjekt me llojin e biznesit, aq më i rëndësishëm bëhet.

Aktualisht jam i koncentruar në fushën e Teknologjisë Informative, por nga fillimi e deri më tani kam ofruar produkte e shërbime të ndryshme. Unë jam i hapur për bashkëpunim me studentë, profesorë dhe i gatshëm për bashkëpunim me secilin që është i motivuar. Do të mirëprisja ndonjë bashkëpunim nga studentët e interesuar, por edhe jam i gatshëm t'i ndihmoj me informacione të rëndësishme ata që dëshirojnë të themelojnë kompanitë e tyre, nga përvoja ime dhe nga njohuritë e fituara deri më tani. UBT ka filluar t'i japë rëndësi të madhe ndërmarrësisë, këtë e vlerësoj shumë, dhe mendoj se nga këtu do të dalin ndërmarrës të suksesshëm. Do ta rekomandoja një revistë që të botohet nga UBT me storie suksesi, këshilla profesionale të përmbledhura dhe artikuj relevant motivues e informues.

UBT Alumni: A jeni duke vazhduar studimet?

Bajraktari: Po, aktualisht jam duke i vijuar studimet master, në UBT, në Fakultetin e Menaxhimit të Mekanikës. Planifikoj që menjëherë pas përfundimit të masterit, të vazhdoj studimet e doktoratës në një universitet prestigjioz në Gjermani.

Albnora Hoti

Në studime master dhe në Zyrën për Projekte në UBT

Albnora Hoti ka përfunduar me rezultate të shkëlqyeshme studimet themelore në Fakultetin për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, ndërsa tani është duke vazhduar studimet master në të njëjtin drejtim. Gjithashtu, ajo është e punësuar në Zyrën për Projekte në UBT, ku zhvillohen projekte të profileve të ndryshme të UBT-së drejtuar organizatave të jashtme.

Përveç drejtimit që i ka pëlqyer në vazhdimësi, ajo thotë se fjalët e mira dhe përvojat e të tjerëve që kanë studiuar më herët këtu, e kanë shtyrë që të regjistrohet në këtë drejtim të studimeve në UBT.

Nga studimet në drejtimin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri ajo veçon lëndët që i ka më për zemër: "Baza e të dhënave, Shkenca Kompjuterike 1 dhe 2, në të cilat ne kemi mësuar për bazat e programimit me JAVA, Inxhinieri Softuerike e gjithashtu edhe Lab Course-et të cilat më kanë mësuar shumë shumë gjëra të reja".

Ajo e quan të rëndësishëm çdo ditë gjatë periudhës së studimeve në UBT. Por, i ka mbetur në mendje si një moment shumë i veçantë, ceremonia e graduimit.

Në UBT kam fituar aftësitë dhe kompetencat në fushën e Shkencave Kompjuterike në nivel mjaft të lartë, që pa

hezituar mund të konkurroj edhe në nivel ndërkombëtar", thotë ajo, duke folur për dijet e përfutura gjatë studimeve në UBT. Ndërsa, rezultatet e mira gjatë studimeve i ka arritur

me një përkushtim të madh dhe gjithashtu rol të rëndësishëm ka luajtur shumë edhe stafi akademik që asnjëherë nuk kanë hezituar në përkrahjen dhe motivimin e saj.



Albert Mustafa

Vizioni i qartë dhe puna sistematike – çelës i suksesit

Dashuria për arkitekturën e bëri Albert Mustafën të lidhet fort më UBT-në. Në kohën kur e përfundoi shkollën e mesme, ky drejtim nuk ishte ende i akredituar në UBT. Ndaj ai u regjistrua në këtë drejtim në Universitetin Shtetëror të Tetovës, ku edhe kishte arritur rezultate të mira.

“Pas një viti, u akreditua dega e Arkitekturës në UBT dhe unë, duke e ditur cilësinë e studimeve në UBT, vendosa të kthehem dhe të vazhdoj studimet aty, edhe pse duhej të filloja prej vitit të parë”, thotë Alberti, duke theksuar se në Tetovë e kishte fituar kushtin për të vazhduar studimet në vitin e dytë, por prapëseprapë vendosi të vinte në UBT.

E këtu, lëndët e tij të preferuara ishin lëndët profesionale, si: Projektim, Konstrukione Arkitektonikë, Gjeometri, Studio 1,2,3. , Historia dhe Teoria e Arkitekturës, Planifikimi urban e të tjera.

Ai veçon si një nga ngjarjet më të rëndësishme gjatë studimeve të tij Konferencën për biznes, teknologji dhe inovacione, e cila u mbajt në vitin e parë të studimeve të tij, 2011-2012.

Alberti thotë se ka përfituar mjaft nga programet e studimit në UBT, por thekson se kësaj i ka ndihmuar në masë të madhe angazhimi individual dhe ndjekja e lëndëve me përpikëri.

Gjithashtu, ai thekson se ka qenë pjesëmarrës në dy udhëtime profesionale që UBT ka organizuar, nga të cilat ka përfituar mjaft. Njëri udhëtim ka qenë nëpër Evropë, tjetri ka qenë në Stamboll të Turqisë.

Ai ka arritur sukses shumë të mirë në studime. Por, si e ka arritur këtë? “Kur e do atë që bën, arritja e suksesit është e pashmangshme. Me angazhim dhe përkushtim të veçantë, dhe duke e bërë punën me dashuri e jo vetëm sa për ta hequr qafe, pastaj pasja e një vizioni për të arritur sukses në studime, si dhe puna dhe mësimi sistematik, të gjitha kanë ndikuar në suksesin e arritur. Të mos harroj të cek këtu se i ashtuquajtur “self study”, apo studimi dhe hulumtimi mbi baza individuale, është shumë i rëndësishëm në arritjen e suksesit”, thekson Alberti.

Ai është shumë aktiv, me idetë e tij, por ende nuk ka një vend të përhershëm pune. Është duke i vazhduar studimet master në arkitekturë, sërish në UBT.

Të bëhesh arkitekt!

“Nuk mjafton të dish të vizatosh, për t’u bërë arkitekt, as të jesh i mirë në matematikë, siç mendojnë disa... Mbase këto mund të jenë dy nga “veglat” që do të të hyjnë në përdorim në rrugën drejt formimit si arkitekt. Mirëpo, të qenurit arkitekt, në kuptimin e plotë të fjalës, në perceptcionin tim, dmth. të kesh aftësinë për të formuar në trurin tënd një “konglomerat” në mes ideve dhe ndjenjave, prodhim apo rezultat i të cilave do të jetë një vepër arkitektonike, e cila edhe mund të jetë projektuar duke marrë për bazë, matematikën, gjeometrinë, ritmin, proporcionet, etj. Por, mbi të gjitha, kjo vepër duhet të ketë aftësinë t’i bëjë njerëzit ta përjetojnë ndjenjësishëm atë”

Profesorët e UBT-së në takimin e organizuar nga ERASMUS MUNDUS “Sigma Agile”

Profesorët e UBT-së, Lulzim Beqiri dhe Ermal Lubishtani kanë qëndruar për disa ditë në Kotorr të Malit të Zi. Ata kanë marrë pjesë në takimin selektues të organizuar nga projekti ERASMUS MUNDUS “Sigma Agile”, në të cilin morën pjesë edhe përfaqësues të universiteteve nga Evropa dhe Ballkani Perëndimor.

Takimi ka shërbyer për përzgjedhjen e kandidateve që kanë aplikuar për mobilitet në 5 nivele: Bachelor, Master, PhD, Post Doc dhe Staff.

Mobilitetet do të fillojnë deri në fund të dhjetorit 2015, ndërsa projekti do të zgjasë deri në vitin 2018.

Universitetet nga Ballkani Perëndimor, që morën pjesë në takim, ishin: UBT e Universiteti i Prishtinës nga Republika e Kosovës; nga Shqipëria ishin Universiteti Evropian i Tiranës, Universiteti i Shkodrës dhe Universiteti i Vlorës; Universiteti i Podgoricës nga Mali i Zi; nga Bosnja dhe Hercegovina ishin Universiteti i Sarajevës, Universiteti i Bihaqit dhe Universiteti i Mostarit; nga Serbia Universiteti i Novi Sadit dhe Universiteti i Nishit.



Ndërsa Universitetet partnere nga BE ishin: University of Warsaw-Poland, City University London-UK, Humboldt Universitität zu Berlin-Germany, Lappeenranta University of Technology-Finland, University of Milan-Italy, University of Salzburg-Austria, University of Twente, ITC Faculty-Netherlands. Universitat Pompeu Fabra – Spain, University Nova de Lisboa-Portugal.

Berna Devexhiu

Në UBT përfituam nga profesorët shumë të përgatitur profesionalisht

"Përfitimi im nga UBT ka qenë më së shumti nga shumë profesorë të aftë, nga të cilët pata kënaqësinë të përfitoj shumë gjëra të rëndësishme dhe të nevojshme për t'u përgatitur për tregun e kufizuar të ditëve tona. Si dhe një përfitim shumë i rëndësishëm për mua internshipi që m'u ofrua nga UBT e me vonë edhe u bëra pjesë e stafit të UBT", thotë Berna Devexhiu

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Devexhiu: Pasi që kam qenë po ashtu studente e Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës, duke mos qenë e kënaqur me sistemin që ende e praktikon ky universitet, në bazë të orientimit nga ana e shoqërisë, si dhe nga përgjigjet pozitive dhe nivelin e tyre të kënaqësisë në UBT edhe unë me shumë kënaqësi vendosa të jem pjesë e këtij institucioni.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Devexhiu: Lëndët mia të preferuara kanë qenë Marketingu, departament të cilin edhe vetë tani jam e punësuar, si dhe edhe shume lëndë tjera, si Burime njerëzore, Shitja dhe menaxhimi i shitjes, Sjellja organizative dhe lidhshme, Menaxhimi i sistemeve të informacionit, nga të cilat kam përfituar shumë, dhe më përcjellin në përditshmërinë time në punë.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Devexhiu: Mund të them shumë haptazi se e gjithë periudha e studimit për mua ka qenë mjaft e rëndësishme, një ndër to vlen të theksohet pjesëmarrja në Forumin Ekonomik, që u mbajt në AUK, ku isha njëra nga tre përfaqësueset e UBT-së. Pjesa më e rëndësishme ishte përballja me studentët e tjerë të kolegjeve universitare private si dhe të UP-së ku patëm mundësinë të shprehim njohuritë gjatë studimeve tona, të ballafaqohemi me njëri-tjetrin, si dhe, pjesa më e rëndësishme, të hedhim poshtë mentalitetin e sotëm ku ballafaqohemi me situata paragjyquese ndaj studentëve të kolegjeve universitare private nga studentët e UP-së, në raport me të cilët ne ishim në avantazh.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Devexhiu: Përfitimi im nga UBT ka qenë më së shumti nga shumë profesorë të aftë, nga të cilët pata kënaqësinë të përfitoj shumë gjëra të rëndësishme dhe të nevojshme për t'u përgatitur për tregun e kufizuar të ditëve tona. Si dhe një përfitim shumë i rëndësishëm për mua internshipi që m'u ofrua nga UBT e me vonë edhe u bëra pjesë e stafit të UBT.

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Devexhiu: Unë mendoj që çdo njeri që është i interesuar për atë që e studion, si dhe puna që bëhet për të arritur



vërtet atë që dëshiron, është rruga drejtë suksesit. Në rezultatet e mia kanë ndikuar edhe shumë mësimdhënës të cilët kanë bërë lëndët aq atraktive dhe kanë dhënë maksimumin për ata që kanë qenë të interesuar të kenë rezultate të mira në studime.

UBT Alumni: Çfarë pune bëni aktualisht?

Devexhiu: Karriera ime filloi në UBT, rreth një vit kam qenë pjesë e stafit të UBT, ndërsa tani jam punësuar në Departamentin e CRM, në një nga institucionet ndërkombëtare të shëndetësisë në zyrat ndërlidhëse në Kosovë. Puna që bëj tani ka të bëjë me mbikëqyrjen e marrëdhënieve me konsumatorë në një institucion ndërkombëtar shëndetësor. Puna ime është mjaft e larmishme, ka gjithnjë gjëra të reja dhe nuk kam shumë kohë të mërzitem, përfitimet e mia janë sidomos në aspektin gjuhësor pasi që kemi të bëjmë me një treg të huaj.

UBT Alumni: A jeni duke vazhduar studimet?

Devexhiu: Për shkak të fillimit të punës, ngarkesës në punë, si dhe interesimit për të bërë përvojë ende nuk kam filluar studimet e mëtejshme, po gjithsesi mendoj që nga shtatori i vitit të ardhshëm t'i vazhdoj studimet, me shumë shpresë jashtë Kosovës.

Rrezart Prebreza

Dija dhe diploma e UBT-së, garanci për punësim

“Porosia ime për studentët e UBT-së është që të mësojnë sa më shumë. Ata kanë zgjedhur universitetin e duhur për të studiuar dhe e kanë shumë më lehtë të kyçen në punë pasi t’i kenë përfunduar studimet në UBT”, thotë Rrezart Prebreza

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Prebreza: Për të studiuar në UBT kam vendosur me përkrahjen e babait, i cili më ka orientuar që të regjistrohem në UBT, duke më thënë se është një fakultet ku ia vlen të studiohet. Gjithashtu, kam bërë edhe një hulumtim rreth UBT-së, ku kam qenë i mahnitur nga përgjigjet që i kam marrë, pasi UBT në drejtimin shkenca kompjuterike është më i miri në Kosovë.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Prebreza: Lëndët e preferuara të miat kanë qenë që të gjitha, por po i dalloj disa: Shkenca kompjuterike dhe Shkenca kompjuterike 2 (Java), database, inxheneria softverike etj.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Prebreza: Gjatë studimeve në UBT kam kaluar shumë periudha të mira. Njëra nder ngjarjet është se kam marrë pjesë në akademinë verore që u mbajt për herë të parë në UBT në vitin 2012.

Gjithashtu, unë jam shpallur studenti më i mirë në shkenca kompjuterike, me mesataren më të lartë në të studimeve në këtë drejtim.

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Prebreza: Për të arritur rezultate të mira gjatë studimeve duhet punë dhe vetëm punë. Duhet lexuar dhe duhet punuar. Pastaj, bashkëpunimi me kolegët është shumë i rëndësishëm për të arritur rezultate të mira



UBT Alumni: A jeni duke punuar pas studimeve dhe ku?
Prebreza: Po jam duke punuar, jam asistent në kolegjin ISPE, ku ligjëroj dhe mbaj ushtrime në lëndën Informatika dhe Informatika për biznes në drejtimin ekonomik. Falë studimeve në UBT dhe përvojës së fituar gjatë studimeve në UBT kam arritur këtu ku jam.

UBT Alumni: A jeni duke vazhduar studimet?

Prebreza: Studimet i kam vazhduar jashtë Kosovës, në drejtimin DATABASE MANAGEMENT, ku i kam përfunduar të gjitha provimet dhe jam ne semestrin e fundit të vitit të dytë në master. Jam duke e përgatitur temën e diplomës.

UBT Alumni: Cila është porosia Juaj për studentët e UBT-së?

Prebreza: Porosia ime për studentët e UBT-së është që të mësojnë sa më shumë. Ata kanë zgjedhur universitetin e duhur për të studiuar dhe e kanë shumë më lehtë të kyçen në punë pasi t’i kenë përfunduar studimet në UBT.

UBT Alumni: Cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

Prebreza: Planet e mia për të ardhmen janë që të bëhem profesor i shkëlqyer. Shpresoj që një ditë do të jem profesor në universitetin ku kam fituar të gjithë dijen, në UBT, dhe të zhvillohem nga ana profesionale (Software developer) sa më shumë që t’i kontribuoj vendit.



UBT prezantoi Qendrën për Siguri Kibernetike dhe Privatësi



Prishtinë, 8 prill. – Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi mori pjesë sot në punëtorinë “Masat e Sigurisë”, në kuadër të diskutimeve për Privatësinë në Epokën Digjitale, të organizuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Para të pranishmëve të shumtë, rektori Hajrizi prezantoi Qendrën për Siguri Kibernetike dhe Privatësi, e cila funksionon në kuadër të UBT-së, dhe foli në detaje për rëndësinë e padiskutueshme të mbrojtjes së të dhënave në epokën digjitale dhe për mundësitë që ofron Qendra e krijuar nga UBT në këtë fushë.

Ai theksoi se kjo qendër do të shërbejë si pikë reference për zhvillimin e diskutimeve në këtë fushë dhe për dhënien e këshillave për të gjitha institucionet e interesuara dhe në të gjitha nivelet.

UBT, tha rektori Hajrizi, ka aktivitete të hershme në fushën e sigurisë, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me universitetet norvegjeze, që ka rezultuar me një përvojë dhe hulumtim me shumë interes.

Ai gjithashtu përkujtoi se UBT ka një marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me të cilën do të bashkëpunojë edhe në të ardhmen, në projekte të ndryshme.

Bashkëpunimin e mirë mes këtyre dy institucioneve e theksoi edhe z.Mentor Hoxhaj nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili bëri një prezantim të gjatë në temën e masave të sigurisë së të dhënave.

“Çështja e sigurisë më nuk është temë për të diskutuar nëse është apo nuk është e arsyeshme, edhe në nivelin global, edhe në nivelin evropian edhe në nivelin kosovar. Motivimi ynë se ne kemi pasur një projekt katërvjeçar me

Norvegjinë dhe me disa universitete në region dhe kemi punuar shumë në fushën e sigurisë. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, kemi programin në fushën e sigurisë dhe themelimin e kësaj qendre. Edhe norvegjezët para një viti kanë themeluar qendrën e tyre në këtë fushë, ku i kanë ndërlidhur të gjitha palët e interesit”, tha ai.

Z.Hajrizi theksoi në vijim se UBT është shkolla më e madhe e IT-së dhe fushat që ofrohen në UBT lidhen mjaft shumë me sigurinë, përfshirë këtu studimet në nivele të ndryshme dhe hulumtimet e shumta.

“Nuk është vetëm siguria në aspektin teknik, por është edhe në aspektin e politikave, në aspektin e standardeve, në aspektin e sistemeve. Është një sistem shumëdisiplinar dhe është shumë e rëndësishme që ne, nga të gjitha fushat, t'i qasemi dhe të merremi me këtë punë. Ne na intereson hulumtimi dhe zhvillimi, sepse e kemi obligim të punojmë në këtë fushë. Na intereson të punojmë edhe në ngritjen e kompetencave profesionale në Kosovë, sepse e shohim se kjo kompetencë mungon, pasi është një fushë e re. Por, konsiderohet si një fushë që do të gjenerojë vende të shumta të reja punës. Do të ketë kërkesa të shumta për personat që merren me sigurinë”, vijoi Hajrizi.

Dr.Hajrizi theksoi në vazhdim se kjo qendër e UBT-së mund të ndihmojë në përmbushjen e standardeve, përdorimit të praktikave të mira, kriterëve ndërkombëtare të kërkuara në fushën e sigurisë kibernetike dhe privatësisë. Ai tha se standardet janë mjetet më të mira të cilat ne mund t'i përdorim për një kualitet më të mirë të punës.

“Ne kemi misionin dhe vizionin tonë. Qëllimi është që të merremi me disa aktivitete, edukimin, shqyrtimin profesional, hulumtimin dhe zhvillimin, certifikimet e sistemeve

sipas standardeve, certifikimet e individëve sipas standardeve dhe praktikave më të mira. Një temë mjaft e rëndësishme është procesimi i të dhënave, hulumtimeve, publikimi i atyre dhe promovimi i temave që lidhen me këtë fushë”, tha Hajrizi.

“Qendra për Siguri Kibernetike dhe Privatësi nuk ka synim që të jetë vetëm qendër e UBT-së. Ajo do të jetë një qendër nacionale, ku ndërlidhen palët e interesit”, theksoi më tej Hajrizi, duke shtuar se ajo do të shërbejë si një mundësi debati dhe pune të përbashkët për çështjet që mbulon fusha e sigurisë së informacionit.

Ai tha se janë një varg kompetencash nga kjo fushë, gjithsesi e re, shumë sfida të cilave duhet dhënë përgjigje, si në nivelin institucional ashtu edhe në nivelin shtetëror, si në nivelin akademik ashtu edhe në nivelin praktik të krijimit të kuadrit në këtë fushë, që është kuadër specifik. Ndaj, krijimi i kësaj qendre synon pikërisht këtë – përgjigjen ndaj sfidave në një fushë të re, por

me shumë interes dhe me shumë rëndësi.

Z.Hajrizi paralajmëroi një punëtori nga 20-22 prill, ku do të trajtohen një varg temash me interes nga fusha e sigurisë kibernetike dhe privatësisë.

Ai theksoi se UBT ka të akredituar në studimet master programin Siguria e Informacionit dhe Privatësia, që është programi i parë i akredituar në këtë fushë jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë, si dhe shumë drejtime të tjera të studimit, si Shkencat kompjuterike, Sistemet e Informacionit. Nisur nga kjo, ekziston një bazë e mirë që të krijojmë disa kuadro në këtë fushë.

UBT ka edhe laboratorët në kuadër të Kampusit Inovativ të UBT-së, ku ka një grup të pajisjeve dhe një hapësirë shumë e mirë për hulumtime në këtë fushë, tha ndër të tjera rektori i UBT-së, gjatë prezantimit të Qendrës për Siguri Kibernetike dhe Privatësi, në punëtorinë e organizuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

UBT dhe Universiteti “Corvinus” nënshkruan memorandum të mirëkuptimit



Prishtinë, 4 mars. – Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi dhe prorektori i Universitetit “Corvinus” me seli në Budapest të Hungarisë, dr. László Palkovics, nënshkruan një Memorandum bashkëpunimi mes dy institucioneve.

Ky memorandum bashkëpunimi mes UBT-së dhe Universitetit “Corvinus”, që është universiteti më i madh në Hungari, krijon mundësi për shkëmbimin e studentëve dhe të mësimeve të doktoratës, bashkëpunimin në fushën e hulumtimeve e një varg fushash të tjera të bashkëpunimit.

Gjithashtu, z.Hajrizi dhe z. Palkovics u dakorduan për shtrirjen e bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus Plus, që përfshin mobilitetin e stafit dhe të studentëve dhe pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta.

Ata gjithashtu theksuan mundësitë e mëdha të bashkëpunimit në kuadër të projektit “Horizon 2020”.

Dr. László Palkovics u njoftua nga rektori i UBT-së, dr.Ed-

mond Hajrizi për funksionimin e UBT-së në sferën e arsimit të lartë, me theks të veçantë me partneritetet ndërkombëtare, ku UBT është institucion që ka marrëveshje bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet më prestigjioze akademike në Evropë e më gjerë.

Prorektori i Universiteti “Corvinus”, z. Palkovics u shpreh më fjalë miradije për UBT-në dhe të arriturat e tij, që kanë qenë faktori kryesor që universiteti që ai përfaqëson ta zgjedhë pikërisht UBT-në për vendosjen e bashkëpunimit sa më të afërt.

Ai gjithashtu theksoi se Universiteti “Corvinus” është pjesë e shumë projekteve ndërkombëtare, pjesë e të cilave është UBT, në shumë prej tyre si i vetmi institucion përfaqësues nga rajoni e më gjerë. Në këtë vazhde, bashkëpunimi mes dy institucioneve do të jetë shumë më i lehtë dhe do të hapë perspektivë për stafin dhe studentët e të dy institucioneve akademike.

Në UBT u mbajt sesiioni informativ për bursat e Forumit Evropian të Alpbach dhe IG Alpbach Kosova



Prishtinë, 23 mars. - Në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) është mbajtur sesiioni informativ për bursat e Forumit Evropian të Alpbach në Austri, organizuar nga UBT në bashkëpunim me IG Alpbach Kosova. Sesiioni informativ për bursa ka zgjuar interesim të madh te studentët e UBT-së, por edhe te studentët e universiteteve të tjera në vend, të cilët në numër të madh e për-collën sesiinin.

Shkumbin Asllani nga "Alpbach Kosova", që bëri prezantimin e programeve për bursa, theksoi se organizata që përfaqëson, duke u nisur nga bashkëpunimi shumë i mirë me UBT-në, ka vendosur që të japë dy bursa të plota për dy studentë të këtij institucioni.

Z.Asllani në paraqitjen e tij fillimisht falënderoi UBT-në dhe rektorin Edmond Hajrizi për bashkëpunimin për vite të tëra.

Ai tha se Forumi Alpbach organizohet në Austri çdo vit, ku shtrohen për diskutim çështje të rëndësishme, ndërsa tema për këtë vit është pabarazia.

Ai në vazhdim tha se Forumi Alpbach pranon rreth 450 studentë dhe gjithsecili student mund të jetë pjesë e këtij forumi, në kuadër të të cilit mund të diskutohen çështje të ndryshme, si shkencat politike, ekonomia, mjekësia, e shumë të tjera.

Për të qenë pjesë e këtij forumi ju duhet një letër motivuese, duke përmbajtur idetë dhe mendimin juaj mbi idenë e këtij forumi, një autobiografi, një transkript i no-

tave, si dhe një dëshmi mbi njohjen e gjuhës angleze ose gjermane, shpjegoi z.Asllani.

"Për të gjithë studentet të cilët dëshirojnë të aplikojnë në IG Alpbach Kosova, ne japim 12 bursa, Në bashkëpunim me Rektorin Hajrizi, kemi vendos të bëjmë një përjashtim - të gjithë studentët kanë të drejtën të aplikojnë në dy vende, edhe në Forum edhe në IG Alpbach Kosova. Kjo rrit shanset e juaja që të fitoni një bursë. Ne si organizatë kemi vendosur që për shkak të bashkëpunimit me UBT-në, t'i japim dy bursa te plota për studentët e UBT-së", tha z.Asllani

Aplikimi duhet të bëhet deri më 31 mars 2015. Adresa për aplikim edhe në Alpbach është alpbach.kosovo@gmail.com Më shumë informata për Forumin Evropian mund të gjeni në: <http://www.alpbach.org/en/unterveranstaltung/seminar-week/> Forumi Evropian Alpbach është ngjarja më e madhe që do të organizohet në muajin gusht 2015, me pjesëmarrës të ndryshëm: studentë, shkencëtarë, juristë, ekonomistë, gazetarë si dhe politologë të rinj nga e gjithë Evropa. Forumi Evropian është një mundësi e mirë për studentët dhe të rinjtë të cilët dëshirojnë të krijojnë kontakte ndërkombëtare në fushën e shkencës, dijes dhe karrierës profesionale.

Forum Alpbach Evropian (EFA) është një platformë ndërdisiplinore për shkencë, politikë, biznes dhe kulturë, i themeluar në vitin 1945.

Agnesa Belegu

Nga UBT në Gjovik në Norvegji e pastaj master në SHBA

“Qëllimet e mia janë të kthehem në Kosovë dhe të jap kontribut maksimal në zhvillimin e një industrie shumë të rëndësishme botërore, e sidomos angazhimin dhe motivimin e kuadrove që veçse i kemi”, thotë Agnesa, e cila do të studioj drejtimin Game Design

“Unë kisha pasion kompjuterët qysh nga mosha e vegjëlisë, kështu që përcaktimi për Shkenca Kompjuterike ishte bërë qysh atëherë. Kur erdhi koha të vendosja për universitet, përkundër faktit që dërgova dokumentet e u pranua në universitete të tjera, në fund u përcaktova për UBT-në. Parimisht për shkak të kurrikulumit më të fokusuar dhe më relevant për shkenca kompjuterike, me besimin që në këtë institucion do të merrja përgatitje më të mirë profesionale”, thotë Agnesa Belegu, e cila përfundoi studimet bachelor në Fakultetin për Shkenca Kompjuterike në UBT, me një sukses për lakmi.

Në një bisedë për “UBT Alumni”, ajo flet për përvojat e studimeve në UBT dhe një varg çështjesh të tjera.

Agnesa thotë se lëndët e preferuara, ku më duket përfitova më së shumti nga eksperiencia e tyre ishin: Inxhinieri Softuerike, mbajtur nga profesor Fisnik Prekazi, Shkenca Kompjuterike I dhe II me profesor Fatos Maxhuni, Inxhinieri e Sistemeve me profesor Naim Preniqin, si dhe Sistemet Operative me profesor Selman Haxhijaha.

Nga 3 vjetët e studimeve në UBT, më duhet të veçoj periudhën e Soft-Lab internship, ku për 5 muaj studentët pjesëmarrës kemi marrë eksperiencë të pamatshme. Gjatë kësaj periudhe ne kemi qenë pjesë e zhvillimit të plotë të një softueri, eksperiencë e cila ka qenë shumë sprovuese dhe ka ndikuar pozitivisht në ngritjen e dijes dhe përvojës në profesionin tonë. Kjo periudhë është e paharrueshme për të gjithë studentët pjesëmarrës. I gjithë falënderimi i takon UBT-së e veçanërisht profesorit Fisnik Prekazi si udhëheqës i projektit, i cili me përvojën e tij na udhëzoi përgjatë këtyre muajve, shprehet më tej Belegu.

Ajo numëron edhe përfitimet ar nga programet e studimit në UBT: “Mund të them që përfitimet e mia nga UBT-ja ishin të shumta duke filluar nga kontakti i ngushtë me profesorët e fushës; Soft-Lab internship, ku përvoja e fituar më dha një shtytje të madhe drejt profesionit tim; e gjithashtu bursa e AEP-Programme e fituar në kuadër të suksesit të treguar, program ky i cili më mundësoi studimet gjatë një semestri në kolegjin universitar Gjovik në Norvegji. Të gjitha këto eksperiencia ndikuan në zhvillimin tim profesional dhe personal, duke krijuar kontakte dhe dijeni të vlefshme për të ardhmen time si zhvilluese e softuerit”.

“Me bursën e AEP-Programme, me ç’rast kalova semestrin e pestë të studimeve në kolegjin universitar Gjovik në Norvegji, unë pata rast të studioja Game Design dhe Programming, dy lëndë në të cilat unë kisha ëndërr të aftësohesha profesionalisht në to. Padyshim, kontaktet e fituara gjatë kohës atje janë kyçe për të ardhmen time profesionale, e pa këtë mundësi nga UBT nuk do të ishte e mundshme kjo eksperiencë. Soft-Lab internship për të cilin diskutova edhe më herët ishte gjithashtu një nga përvojat e mundësuar nga angazhimi im në UBT. Vendimi të studioja në këtë kolegji universitar ishte definitivisht vendimi më i mirë që mund të merrja për ardhmërinë time”, shton në vijim Belegu.

E pyetur si i ka arritur rezultatet shumë të mira gjatë studimeve, ajo përgjigjet: “Mund të them se ishte falë pasionit për profesionin e përcaktuar, lëndëve dhe shumicës së profesorëve të cilët me angazhimin e tyre të palodhshëm më bënë të dua të mësoj më shumë, e sidomos nga gabimet që si studente pa përvojë ishin të pashmangshme. Kyçe në këtë sukses ishte



edhe rrethi shoqëror, e jo pa qëllim thonë: “Me kënd rri, ashtu bëhesh”. Përgjatë studimeve kam qenë e rrethuar me njerëz të zellshëm e të punës, të dedikuar dhe të besueshëm, e duke motivuar njëri-tjetrin kemi arritur suksese të mëdha. Gjithashtu edhe familja me përkrahjen e tyre të vazhdueshme në studimet dhe vendimet e mia profesionale ka ndikuar në shtimin e motivimit për të ndjekur suksesin mbi të gjitha. Forca më e madhe vjen nga brendësia, duhet të kemi guxim të mos e rrethojmë vetën me barriera të brendshme dhe t’i kemi të qarta synimet tona. Këto, sipas meje, janë çelësi i suksesit për çdo njeri. Agnesa aktualisht punon si zhvilluese e softuerëve në kompaninë ePayTech, kompani e specializuar në fushën e teknologjisë informative e cila ofron produkte dhe shërbime softuerike për klientët në Kosovë dhe me gjerë. Kompania shquhet për përvojë të theksuar në këtë fushë duke qenë prezente në treg me klientë të mëdhenj si administrata komunale, kompani publike, banka, institucione tjera financiare, korporata dhe biznese të mëdha e të mesme.

Produktet dhe shërbimet e kompanisë zhvillohen duke pasur si kriter kryesorë kërkesat dhe dëshirat e klientëve. Rrjedhimisht kompania zhvillon produktet/shërbimet e saj në bashkëpunim dhe pajtim të plotë me klientët, me qëllim të përmbushjes së kërkesave sipas pritshmërisë së tyre.

Aktualisht është e angazhuar veçanërisht me projektin PRAKTIK në qytetin e Pejës. Ky projekt ka për qëllim aftësimin e kuadrove profesionale në fushën e IT-së – me fokusim në moshat mbi 15 vjeçare, e së voni edhe me kurse për të rinj të moshave 9-14 vjeçare.

Ajo gjithashtu planifikon të vazhdojë studimet e Masterit jashtë vendit, në fushën e Game Design. Lidhur me këtë shprehet: Pasi kam pasur qëllim të vazhdoj studimet e Masterit jashtë vendit, kam kërkuar bursa që ofrojnë mundësi të tilla. Kam aplikuar dhe jam kualifikuar për bursën e USAID TLP-SP Programme për studime të masterit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Drejtimi i përcaktuar është Game Design, e cila është degë e cila merret me studimin dhe zhvillimin e lojërave si koncept dhe produkt, nga pika e idesë deri në lansim të plotë të produktit. Qëllimet e mia janë të kthehem në Kosovë dhe të jap kontribut maksimal në zhvillimin e një industrie shumë të rëndësishme botërore, e sidomos angazhimin dhe motivimin e kuadrove që veçse i kemi.

Meriton Kabashi

Shkathtësitë e shkëlqyeshme profesionale çdo ditë i praktikon në punë

Meriton Kabashi ka filluar studimet në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, por shkaku i angazhimeve profesionale, pasi ka absolvuar, vitin e fundit ka vendosur të transferohet në UBT.

Kam hulumtuar rreth Universiteteve që e kanë të akredituar degën Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri. Kam bashkëbiseduar me disa shokë dhe kolegë dhe, duke e njohur paraprakisht profilin e Prof. Dr. Edmond Hajrizi, kam vendosur të transferohem në UBT. Në afat rekord i kam përfunduar provimet e nivelit bachelor dhe menjëherë e kam regjistruar shkallën Master (SHKI), ku provimet i kam përfunduar me afat dhe pres vetëm mbrojtjen e temës”, thekson z.Kabashi.

Për të, fushat e preferuara gjatë studimeve ishin Menaxhimi i Projekteve dhe Sistemet e Informimit, Rrjetet e ndërmarrjes, E-Teknologjia, IT Strategjia, Sistemet e Informimit, Rrjetet dhe rrugëtimi e të tjera.

Ai thekson se nga programi BA dhe MA në UBT ka marrë njohuri dhe shkathtësi të shkëlqyeshme profesionale të cilat çdo ditë i praktikon në punë.

Ndërsa, teksa flet për rezultatet e arritura gjatë studimeve, thekson se rezultatet e mira gjatë studimeve arrihen me punë sistematike dhe përkushtim, bashkëpunim me mësimdhënës dhe kolegë.



Meriton punon si mësimdhënës në Shkollën e Mesme Teknike “Skënder Luarasi”, në Suharekë, ku ligjëron lëndën e TIK-ut. Ai është trajner dhe Testues i Certifikuar i ECDL-së: (XP, Office 2003 & Windows 7, Office 2010)... Planet e tij për të ardhmen janë që të regjistrohen në doktoratë.

Andrra Sylqe

Njohuritë e studimeve, ndihmesë e madhe për punën në praktikë

Andrra Sylqe ka përfunduar studimet më Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, me notë të përgjithshme shumë të lartë. Aktualisht punon në një kompani që merret me kontabilitet. Dhe ka një porosi për studentët e rinj, që ata t'i përcjellin ligjëratat dhe t'i kryejnë provimet me kohë, në mënyrë që të kenë sukses më të lartë në të ardhmen.

Fillimisht, kur u regjistrua në UBT ajo mendoi që përmes këtij institucion të krijojë mundësi për të vazhduar studimet jashtë vendit, por për arsye personale studimet i përfundoi në këtë institucion. Në planet e saj është që studimet master t'i vazhdojë jashtë vendit, në ndonjërin nga universitetet partnere të UBT-së, (në Londër, në Holandë etj.).

E në UBT thotë se lëndët e saj të preferuara kanë qenë Komunikimi afarist dhe të folurit publik, Menaxhimi i sistemeve të informacionit, Investimet dhe analizat financiare, Metodatat e hulumtimit, E drejta biznesore, Shkrimi akademik, Hyrja në burimet njerëzore e të tjera.

“Nëpërmjet diplomës së UBT-së jam punësuar në një firmë për kontabilitet, tatime dhe konsulencë. Gjatë kohës

së studimeve në UBT, që nga viti 2011, kam punuar edhe në dy festivale në Prizren, pra në “Dokufest” dhe “Ngomfest”, me ç'rast njohuritë e përfituara i kam shfrytëzuar dhe vazhdoj t'i përdori edhe sot në vendin e punës”, thekson Andrra.

Ajo nuk ka qenë në udhëtime studimore jashtë vendit, por përmend si përvoja interesante disa video-konferenca me studentë nga Japonia, të realizuara nga UBT.

E kur flet për rezultatet e dalluara që ka arritur në studime, ajo thotë se ato i arritur duke bashkëpunuar me koleget e saj, si dhe duke e menaxhuar kohën në mënyrë efektive për t'i përfunduar provimet në kohë.

Andrra aktualisht punon në firmën për kontabilitet, tatime dhe konsulencë “Arizona Partners”, ku punët që bëhen ndërlidhen me shumë procese të biznesit që lidhen me kontabilitet.

Ndërsa, planet e saj për të ardhmen janë që të përfitojë eksperiencë sa më të mëdha duke u angazhuar më shumë në vende të ndryshme të punës, si dhe që t'i vazhdojë studimet master.

Teknologjia në shërbim të Shëndetësisë dhe të Edukimit



Prishtinë, 11 mars. - Konferenca "Ditët Austriake-Kosovare 2015", e moderuar nga presidenti i Asociacionit Austriak-Kosovar, Gunther Fehlinger, i ka vazhduar diskutimet në temën e E-Shëndetësisë dhe E-Edukimit dhe përparësitë e tjera që ofron teknologjia informative në të gjitha fushat.

Në këtë vazhdë, për përdorimin e e-teknologjisë në shëndetësi foli z.Olegas Niaksu nga Lituania, i cili paraqiti për një varg përvojash nga projektet në e-shëndetësi në Shqipëri dhe sidomos në disa vende të Afrikës, ku ai ka marrë pjesë në zbatimin e tyre.

"Para 17 vitesh në Afrikë ne e filluam regjistrimin e pacientëve në sistemet spitalore. Qytetarët presin shërbime shëndetësore efektive, pritet dhe synohet përkujdesi më i madh ndaj atyre që jetojnë në zonat rurale. Ajo çfarë ne kemi tentuar ta bëjmë në Afrikë, pasi që atje dihet se sëmundjet ngjyeshme janë më të shpeshta, ishte që të krijojmë qendra të parandalimit të sëmundjeve e jo qendra shëruese nga to", tha z.Niaksu.

"Investimet nga shtetet e ndryshme bënë që të rregullohej rrjeti i mbingarkuar dhe të krijohej një sistem spitalor i cili tashmë lidh jo vetëm qytetet por edhe shtetet", tha Olegas Niaksu.

Edmond Hajrizi: "Zgjidhja e problemeve është arsimi"

Z.Fehlinger e ftoi në vazhdim Presidentin e UBT-së, Edmond Hajrizi për ta marrë fjalën. Njëkohësisht e uroi atë për sukseset në garat me robotët që luajnë futboll, ku UBT ka zënë vendin e parë në garë me shumë univer-

sitete nga e gjithë Evropa. "Ju keni një arritje të lartë, keni vendin e parë në robotikë", u shpreh Fehlinger.

Ndërsa, rektori Hajrizi vuri theksin te rëndësia e shpërndarjes së internetit. Ai tha se 85 për qind e territorit të vendit mbulohet me rrjet të internetit, që për UBT-në, si universitet i teknologjisë është shumë e rëndësishme.

"Si shtet i ri, kemi ekspertë në lëmi të ndryshme, por janë të paktë në numër. Ne duam të kontribuojmë në këtë aspekt. Ne si organizatë e teknologjisë kërkojmë më të mirën, kërkojmë të gjejmë gjërat më të mira dhe të nxjerrim ekspertë të rinj. Kemi nisur në vitin 2001 kurse tash në vitin 2015 jemi shkollë më e madhe e teknologjisë në rajon. 800 studentë në drejtimet e teknologjisë janë shumë, por kjo krijon potencial të madh! Jemi të parët në Ballkan të certifikuar me çmimin për ekselencë, gjithashtu edhe me shumë certifikime të tjera për cilësi na ISO. Këto çmime ne nuk i kemi për t'i treguar por për të punuar me to. Kemi shumë programe për studim dhe këtë e konsiderojmë si përgjegjësi për edukimin e të rinjve", tha z.Hajrizi.

Ai tha se zhvillimi profesional bëhet me trajnime, si p.sh Cisco e tash edhe Microsoft e shumë të tjera. Pjesë tjetër e zhvillimit është që ne të arrijmë standardin dhe t'u afrohem liderëve të shkollimit botëror.

"Kampusi ynë njihet në mbarë Ballkanin si një ndër më të mëdhenjtë dhe me kushte shumë të mira për zhvillimin e studenteve", tha ndër të tjera Edmond Hajrizi.

Në konferencë foli edhe Jovce Plastinovski përfaqësues i Microsoft në Maqedoni.

"Transparenca është ajo që ne e kemi kërkuar ndër vite

në projektet tona. Kemi hequr fjalëkalimet e ueb-faqeve të shërbimeve zyrtare dhe në fillim ata thanë: Ju po e rrëzoni aplikacionin tuaj! Kurse ne u përgjigjëm: Le ta provojmë. Arritëm ta mposhtim korrupsionin dhe njerëzit ishin të lirë të aplikojnë për vende pune. Arritëm të krijojmë aplikacion për regjistrimin e biznesit nga laptopet, telefonat mobilë e pajisjet e tjera teknologjike”, tha ai.

Shembuj të ndryshëm të sistemeve shëndetësore mori edhe zonja Elisabeth Campestrini, e cila tregoi që në muajin prill ajo, bashkë me disa kolegë të saj, do të mbajë një tjetër lloj të seminarit për E-shëndetësinë.

Busek: Sfida e shoqërisë është edukimi

Dr. Erhard Busek, President i Institutit për Rajonin e Danubit dhe Evropës Qendrore dhe ish Ministër i Arsimit i Austrisë, theksoi se sfida e shoqërisë është edukimi. “Duhet pranuar që kemi mungesë të resurseve, të vetmen dhuratë që e kemi është truri”, tha Busek. Sipas tij arsimimi është parakusht për zhvillimet e mëtutjeshme dhe duhet fushatë publike për arsimim.

“Po jetojmë në ndryshimin e kushteve që na rrethojnë. Telefoni mobil po na mundëson të komunikojmë me gjithë botën, të shprehim idetë dhe të shkëmbejmë përvojat tona. Pasi u shfaq interneti mund të lidhemi me njëri-tjetrin dhe kjo gjë është në favor të qenies njerëzore”, tha z. Busek.

Ai tha se po jetojmë në tregun e botës dhe se konkurrenca është e dukshme. Që ta kuptojmë njëri-tjetrin së pari duhet ta dëgjojmë.

“Mua më bëjnë përshtypje në Kosovë se në çdo program kemi forume, diskutime të ndryshme. I konsideroj shumë të rëndësishme këto diskutime”, tha Dr. Busek.

Ai përmendi edhe stafin akademik, që luan një rol mjaft të madh në avancimin e njohurive.

“Po pretendojmë ti avancojmë profesorët me trajnime ku zhvillohen aktivitetet e ndryshme. Kemi mjaftueshëm buxhet por mungojnë vetëm njerëzit e shkolluar dhe gjithçka lidhet me shkollimin dhe arsimimin”, theksoi Busek.

Në vazhdim foli edhe Blerim Rexha, mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës, i cili u shpreh se gjeneratat e reja po e ndryshojnë botën dhe vuri theksin te përdorimi i internetit dhe rrjeteve sociale.

“Interneti nuk shërben vetëm që të postojmë gjëra nëpër rrjetet sociale, por edhe të gjurmojmë nëpër ueb-faqe të ndryshme të rëndësishme”, tha z. Rexha.

Ai gjithashtu foli edhe për funksionin e teknologjisë informative në shërbim të edukimit dhe të shëndetësisë. Ndërsa Elisabeth Schleicher, eksperte e tregut (E-Commerce), tha se ndihet e privileguar dhe ka nderin që t'i ndajë me studentët dhe me stafin akademik të UBT-së faktet dhe të dhënat për tregun botëror.

Gjatë prezantimit të saj, ajo u fokusua në të dhënat për



kompaninë, vlerat e konsumatorit, mundësitë për Kosovën dhe mënyrën e funksionimit.

Në debatin për rolin e teknologjisë në fushën e edukimit, rektori i UBT-së, dr. Edmond Hajrizi, shpalosi të dhëna për zbatimin e teknologjisë në institucionin që ai drejton.

Në fushën e edukimit ai përmendi në UBT ai përmendi: E-edukimi, E-libraria, E-Administrata, E-Partneriteti, E-Cilësia, E-Orari, E-Pjesëmarrja, E-testet, E-Syllabuset, Stafi i UBT-së dhe studentët.

Në fushën e zhvillimit profesional: ICT Akademia, CISCO, Menaxhment, Biznes si dhe stafi E-Staff.

Në fushën e hulumtimeve: E-Publikimet, E-Dokumentimet, Interneti, UBT Radio.

Hajrizi përmendi edhe rëndësinë e partneritetit që ka UBT-ja me Universitetet tjera si dhe për projektin Erasmus Mundus, në të cilën Universiteti për Biznes dhe Teknologji është e anëtarësuar dhe studentët mund të marrin bursa për studime jashtë vendit.

Tekstin e përgatitën: Albina Zeneli, Besart Troshupa, Drin Jakurti

Erhard Busek: Duhet të shikoni me një vizion më të qartë që të zhvilloheni dhe të bëheni më të mirët

Prishtinë, 11 mars. - Konferenca "Ditët Austriake-Kosovare 2015", e moderuar nga presidenti i Asociacionit Austriak-Kosovar, Gunther Fehlinger, i ka vazhduar diskutimet në temën "Së bashku në Evropë - 20 vitet e Austrisë në BE dhe marrëdhënie austriak të Kosovës në këtë periudhë".

Folës të shumtë, kosovarë dhe austriakë, kanë folur për përvojat dhe të dhënat e bashkëpunimit Kosovë-Austri. Presidenti i Asociacionit Austriak-Kosovar, Gunther Fehlinger foli për Qeverinë e re dhe fokusin e E-Qeverisjes, dhe qasjen e re të qytetarëve që do të kenë një nivel tjetër të besimit në Qeverinë e Kosovës.

Eva Michlits: Azil kërkimi nuk është mjet për zhvillim ekonomik

Në vazhdim, Eva Michlits, konsulle e Austrisë në Kosovë, ndër të tjera u shpreh se rruga e migrimit nuk është mjet për ta zhvilluar Kosovën dhe as bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Austrisë.

"Është kënaqësi t'ju flas për stabilitetin dhe të ardhmen e përbashkët të Evropës Juglindore. Austria dhe Kosova janë aleat shumë të afërt, miq. Austria ka bërë shumë që ta mbështesë Kosovën, pas luftës dhe në rrugëtim drejt pavarësisht, si dhe në rrugën e Bashkimit Evropian", tha ajo.

Në vazhdim, ajo foli për valën e azilkërkuesve ilegalë nga Kosova drejt Austrisë dhe vendeve të tjera të Bashkimit Evropian, që sipas saj ishte një veprim i papritur dhe i befasishëm.

"Azil kërkimi nuk është mjet për zhvillim ekonomik. Ne e dimë që duhet të bëhet shumë në Kosovë, por kjo qasje është imazh i keq për Kosovën dhe Austrinë, kështu që të punojmë së bashku që ta zhvillojmë Kosovën dhe mos ta shfrytëzojmë të drejtën e azilit në Austri. Austria ka filluar një fushatë të madhe dhe ka treguar rezultate", vijoi ajo. Ajo tha një bashkëpunim edhe më i mirë Austri-Kosovë mund të ndihmojë për t'i shmangur këto befasi.

"Austria ka bërë shumë që ta mbështesë Kosovën në asistencë teknike dhe në fushën kulturore, dhe gjithmonë mbështetemi në angazhimin e Kosovës në të ardhmen evropiane. Duhet të jemi më ambiciozë dhe të fokusohemi në atë çfarë është arritur dhe çka mund të arrijmë në të ardhmen. Vjena ka lehtësuar dialogun në Evropën Juglindore me projekte dhe ne jemi momentalisht duke implementuar një program softuerik për qeverisje të mirë, gjithashtu kemi zhvilluar kornizën e zhvillimit dhe bashkëpunimit në edukim si dhe në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Jemi të angazhuar për suksesin e Kosovës edhe në fushat socio-ekonomike", tha ndër të tjera Eva Michlits, konsulle e Austrisë në Kosovë.



Busek: Të bëheni më të mirët - kjo është një sfidë shumë e madhe

Dr. Erhard Busek, President i Institutit për Rajonin e Danubit dhe Evropës Qendrore dhe ish Ministër i Arsimit i Austrisë, i bëri një paraqitje të gjatë historisë së raporteve të Austrisë me Shqipërinë e me Kosovën, si dhe me gjithë rajonin e Evropës Juglindore, duke nisur nga fillimi i shekullit të kaluar dhe përgjatë gjithë këtij shekulli dhe shekullin që jemi tash.

Ai numëroi sfidat nëpër të cilat ka kaluar Austria, në periudhat e rëndësishme të historisë, por edhe qëndrimin që kanë mbajtur qytetarët, gjenerata të tëra, për t'iu bërë ballë sfidave të kohës dhe për ta zhvilluar shtetin, në një shkallë shumë të lartë dhe me shumë ndikim, siç është sot.

Duke folur për 20 vitet e Austrisë në Bashkimin Evropian, ai e quajti këtë një të arritur të madhe, e cila mund t'iu shërbejë si model të tjerëve, e konkretisht Kosovës. Ai përmendi prezencën në shtetin tonë e në rajon të Bankës Raiffeisen dhe kompanive të fuqishme austriake, dhe theksoi se fuqia ekonomike e Austrisë mbështetet me faktin se ndërmarrjet nga ky shtet e kanë shtrirë jashtë vendit aktivitetin e biznesit.

Z.Busek theksoi se Evropa Juglindore duhet të jetë pjesë e Bashkimit Evropian. "Nuk kam dëgjuar që dikush ka thënë që të mos i pranojmë këta. Me gjithë dashurinë time për vendin e juaj, Bosnja Hercegovina është në pozitë më të keqe sesa Kosova. Por, mos e shfrytëzoni këtë që të thoni se jeni më mirë se Bosnja. Duhet të shikoni me një vizion më të qartë që të zhvilloheni dhe të bëheni më të mirët. Kjo është një sfidë shumë e madhe", tha ndër të tjera z.Busek.

Në vazhdim të konferencës foli Ramadan Ilazi, zëvendësministër i integriteteve evropiane, i cili fillimisht, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e falënderoi z.Busek për angazhimin e tij rreth Kosovës.

Ai foli gjerësisht për angazhimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për përmbushjen e kriterëve drejt integritetit të vendit në institucionet euroatlantike dhe sidomos përkushtimin e qeverisë për të përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara.

Z.Ilazi gjithashtu përmendi një varg sfidash, që nga dukuritë negative me të cilat përballen shteti dhe shoqëria e deri te papunësia e madhe dhe problemi i migrimit ilegal, që kërkojnë një zgjidhje, e cila duhet të gjendet në bashkëpunim edhe me institucionet ndërkombëtare.

Christian Rupp, koordinatori i Qeverisë së Austrisë për qeverisje elektronike foli për përvojat e zhvillimit të E-Qeverisjes në Shqipëri në Maqedoni.

"Kemi përmendur rëndësinë e kësaj qeverisjeje, që është një mundësi për të ndërtuar transparencën dhe besimin, siç ka ndodhur në shumë vendet tjera, por kjo gjeneron



edhe punë të reja. Kjo mund të jetë një mundësi, sidomos në këtë Universitet, kjo mund të jetë një model i mirë se si mund të punoni në multimedia, që është një perspektivë për të ardhmen tonë", tha ndër të tjera z.Rupp.

"Ne si UBT nuk do të ekzistojmë pa këtë koncept bashkëpunimi ndërmjet Austrisë dhe Kosovës. Austria ka qenë i vetmi vend i cili ka hapur dyert tyre për të na ndihmuar. Unë kujtoj nga fillimi ndjenjën të kemi një partneritet për të na ndihmuar dhe kanë investuar shumë fonde. Në Gjermani kanë thënë se Kosova është një vend shumë i vogël, po ashtu edhe në Angli. Pra, në Austri ka pasur institucione por edhe ekspertë që na kanë ndihmuar", theksoi rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi, duke folur për bashkëpunimin Kosovë-Austri, respektivisht nga bashkëpunimi i tij dhe i UBT-së me institucionet austriake dhe ekspertët e fushave të ndryshme, përvoja e të cilëve u përcoll edhe në Kosovë.

Bajrami: Do të krijojmë kushte më të mira për biznesin vendor, edhe më shumë lehtësi për investitorët e huaj

Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës, zonja Hykmete Bajrami, duke folur në konferencë, paraqiti një varg të dhënash për fushat e bashkëpunimit Kosovë-Austri dhe për përpjekjet e institucioneve të Kosovës për zgjerimin e këtij bashkëpunimi, por edhe për zhvillimin e përgjithshëm të vendit.

Zonja Bajrami shtoi se qeveria po punon për hapjen e vendeve të punës dhe hapjen e perspektivës së qytetarëve. Në këtë kontekst ajo është angazhuar për heqjen e vizave për banorët e Kosovës.

Ajo theksoi fillimisht se ekonomia e Kosovës varet nga taksat e importit dhe remitencat, ndërsa theksoi se qeveria ka synim ta ndryshojë këtë gjendje.

Sipas saj, do të ndryshohen politikat për të ndihmuar bizneset prodhuese dhe për të mbështetur në përgjithësi biznesin privat.

Ministrja Bajrami gjithashtu u angazhua për zgjerimin e bashkëpunimit me bizneset austriake.

Qeveria e Kosovës po punon që të krijojë kushte më të mira për bizneset në Kosovë. Kemi përkrahjen nga donatorët, duke i përfshirë edhe ata austriakë. Unë dhe u ktheva nga Austria, ku komiteti Kosovë-Austri mbajti një panair ku u prezantuan mbi 50 biznese austriake, disa prej të cilave edhe më përvojë në rajon e edhe në Kosovë. Jemi kërenar për sukseset e tyre por edhe për sukseset e bizneseve kosovare në Austri, por jam e pakënaqur me investimet e bëra, theksoi ministria Bajrami.

Qeveria e Kosovës është në dijeni për pengesat dhe vështirësitë dhe po mundohemi që të luftojmë kundër tyre. Po punojmë kundër korrupsionit dhe po tentojmë që bizneset të kenë hapësirë dhe të gjitha kushtet për zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Duam që të krijojmë një sistem i cili nuk e merr parasysh kush është kryeministër, ministër, drejtor apo çfarëdo tjetër. Jemi në mesin e top-reformatorëve nga Banka Botërore, po bëhet fuqizimi i sektorit privat dhe po krijohen ligjet. Kemi filluar me e-regjistrimin në agjencinë e regjistrimit të biznesit, i cili tashmë bëhet online. Shumë shpejt do të fillojë edhe programi i e-prokurorit i cili do të luftojë korrupsionin dhe ku është shumë e rëndësishme që të përfshihen të gjitha institucionet, tha ndër të tjera ministria Hykmete Bajrami.

Wright: Në Kosovë ka 450 hotele, por pak turizëm

Robert Wright, drejtor ekzekutiv i Raiffeisen Bank në Kosovë tha se bizneset austriake në Kosovë janë në një numër të konsiderueshëm.

“109 kompani austriake ekzistojnë në Kosovë. Gjendja e Kosovës nuk është më e mira e mundshme, ka vend për shumë përmirësime. Cila është arsyeja që dikush të investoj këtu? Nuk besoj që do të ishte përgjigje e mirë rinia, që të huajt të investojnë këtu. Ne japim kredi por kthimi i tyre është i vështirë. Ne kemi në Kosovë 450 hotele, por sa turizëm ka këtu? Të mos them fare. Kemi 1000 pompa të benzinës kur ti mund të shkosh nga Prishtina deri në Tiranë dhe të mos kesh fare nevojë për furnizim me derivate”, theksoi ai.

Ndërsa, Vjosa Huruglica nga Oda Austriake e Bizneseve, tha se biznesmenët nga Austria nuk janë shumë të kënaqur me gjendjen në Kosovë, megjithëse Austria është në mesin e investitorëve kryesorë në vendin tonë.

“Z. Wright përmendi 109 biznese në Kosovë, mendoj se është një numër mjaft i madh dhe bizneset nga Austria janë ndër me të shumtat në numër në Kosovë”, tha ajo. Znj. Huruglica tregoi edhe për një anketë të bërë me bizneset austriake. Sipas saj, 50 për qind thanë se situata në Kosovë nuk është e kënaqshme, deri sa 25 ishin optimistë. Për bizneset e tyre 31 për qind deklaruan se është gjendje pak më e mirë në 3-mujorin e parë të vitit 2015.



Planet e bizneseve austriake janë që të investojnë më shumë në Kosovë dhe të rritin numrin e të të punësuarve”, tha znj. Huruglica, duke shtuar se Oda e Bizneseve Austriake në Kosovë dhe biznesmenët presin nga qeveria e re mbrojtje të investimeve, presin që të mos vazhdohet me korrupsion dhe të ketë siguri politike.

Dr. Erhard Busek në vijim kërkoi nga ministria Hykmete Bajrami që të tërheqin partnerë, të krijohen marrëveshje dhe të krijohet një treg i mirëfilltë.

Numri jashtëzakonisht i madh i të papunëve kërkon ide themelore, të cilat janë arsimimi dhe ekonomia. Kosova, nuk është pjesë e iniciativës strategjike për ekonomi në rajon, por ajo çfarë mua më pengon më shumë është mosbashkëpunimi mes vendeve fqinje, ku secili vend punon vetëm për vete. Gjëja më negative është se fonde ka, por projekte jo. Specifikoni çka ju nevojitet! Projektet infrastrukturore, nëse nuk i keni njerëzit e trajnuar, nuk nevojiten asgjë, theksoi z.Busek.

Në sesionin e pasdites të konferencës është diskutuar për temën “E-Qeveria dhe bashkëpunimi ndërmjet Austrisë dhe Kosovës, si faktor kyç për tokën më të mirë, menaxhimin urban dhe Kadastrin”.

Përfaqësuesit e bizneseve austriake e kosovare diskutuan për bashkëpunimin mes tyre.

Në margjina të ditës së dytë të konferencës janë zhvilluar edhe takime të përfaqësuesve të bizneseve nga Kosova dhe nga Austria.

Shumë përfaqësues të biznesit kanë ndjekur punimet e konferencës dhe janë njoftuar më për së afërmi me bashkëpunimin ekzistues, por edhe për format dhe mundësitë e reja të bashkëpunimit.

Përfaqësuesit e bizneseve të të dyjave vendeve kanë diskutuar për një varg çështjesh me interes, ndërsa për ta një përvojë shumë të mirë kanë paraqitur idetë e paraqitura në konferencën dyditore, por edhe fjalimet afirmative dhe përkrahëse të ministrave dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë të Kosovës për përkrahjen dhe krijimin e një klime të re të bashkëpunimit në të gjitha fushat e sidomos në ekonomi, duke eliminuar një varg barrierash e pengesash, që jo rrallë herë e kanë vështirësuar këtë bashkëpunim.

Besart Prebeza

Nga UBT në Ministrinë e FSK-së

“Gjatë studimeve në UBT kam kaluar shumë periudha të mira. Njëra ndër ngjarjet është se kam marrë pjesë në akademinë verore që u mbajt për herë të parë në UBT në vitin 2012. Po ashtu, një tjetër ngjarje është shpallja ime si një ndër studentët më të mirë në shkenca kompjuterike, me mesataren më të lartë në shkenca kompjuterike, si dhe shumë ngjarje të tjera, si për shembull, konferencat që janë mbajtur në UBT e të tjera”, thotë Prebeza

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Prebeza: Për të studiuar në UBT kam vendosur me përkrahjen e babait, i cili më orientoi që të regjistrohem në UBT, që është një fakultet në të cilin ia vlen për të studiuar dhe është një ndër fakultetet më me vlerë në Kosovë.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Prebeza: Lëndët e preferuara të miat kanë qenë që të gjitha, por po i dalloj disa: Shkenca kompjuterike dhe Shkenca kompjuterike 2 (Java), Database, Inxhinieria e softuerit, Aplikimi në ueb, Inxhinieria e uebit etj.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Prebeza: Gjatë studimeve në UBT kam kaluar shumë periudha të mira. Njëra ndër ngjarjet është se kam marrë pjesë në akademinë verore që u mbajt për herë të parë në UBT në vitin 2012. Po ashtu, një tjetër ngjarje është shpallja ime si një ndër studentët më të mirë në shkenca kompjuterike, me mesataren më të lartë në shkenca kompjuterike, si dhe shumë ngjarje të tjera, si për shembull, konferencat që janë mbajtur në UBT e të tjera.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Prebeza: Kam përfituar shumë, pasi në bazë të programit studimit në UBT unë jam këtu ku jamë, pasi në UBT i kam marrë hapat e parë si zhvillues (developer).

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Prebeza: Për të arritur rezultate të mira gjatë studimeve duhet punë dhe vetëm punë, dmth. duhet lexuar dhe mësuar shumë. Mirëpo, një pjesë e rëndësishme për të arritur rezultate të mira gjatë studimeve është edhe komunikimi me kolegët, ku duhet të jesh sa më miqësor me ta dhe të mësoni së bashku. Po ashtu, edhe përcjellja e ligjëratave dhe ushtrimeve, konsultimet me profesorët...


UBT Alumni: Çfarë pune bëni aktualisht?

Prebeza: Po. Jam duke punuar. Jam inxhinier i IT-së në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK). Falë studimeve në UBT dhe përvojës së fituar gjatë studimeve në UBT kam arritur këtu ku jam.

UBT Alumni: Ku jeni duke i vazhduar studimet?

Prebeza: Studimet i kam vazhduar jashtë Kosovës, në South East European University, në drejtimin DATABASE MANAGMENT, ku i kam përfunduar të gjitha provimet dhe jam në semestrin e fundit të vitit të dytë në master. Tani jam duke punuar në temën e diplomës dhe shpresoj që kah mesi i vitit ta mbrojë temën e diplomës dhe të bëhem Mr.Sc.

UBT Alumni: Cila është porosia Juaj për stu-




dentët e UBT-së?

Prebeza: Porosia ime për studentët është që të mësojnë sa ma shumë, pasi vetëm me dije mund të arrijnë rezultatet. Të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që ju jepen për mësim në UBT. Keni zgjedhur universitetin e duhur për të studiuar dhe e keni shumë më lehtë të kyçeni në punë, pasi t'i keni përfunduar studimet në UBT.

UBT Alumni: Cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

Prebeza: Planet e mia për të ardhmen janë që të bëhem profesor dhe shpresoj që një ditë do të jem profesor në universitetin ku kam fituar të gjithë dijen, në UBT, si dhe të zhvillohem nga ana profesionale (Software developer) sa më shumë që t'i kontribuoj vendit.



Leonard Rexhepi

Pjesëmarrja në projektimin e kampusit të ri të UBT-së, një ndjenjë e veçantë

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Rexhepi: Pasi që Arkitektura ka qenë gjithmonë drejtimi im i preferuar, dhe pasi që jam bindur se ka një nivel shumë cilësor të arsimit, nuk ka qenë aspak e vështirë që unë të zgjedhë UBT-në.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Rexhepi: Ndër lëndët e mia të preferuara në drejtimin tim të arkitekturës ka qenë "Punë praktike në terren", ku kemi vizituar objekte gjatë ndërtimit, i kemi parë punimet për së afërmi dhe kemi përcjellë punimet gjatë tërë semestrit. Kjo ka qenë një lëndë që më ka shërbyer shumë pas përfundimit të studimeve.

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Rexhepi: Edhe pse gjatë studimeve të mia ka pasur shumë ngjarje që unë i konsideroj të rëndësishme, një ndër ngjarjet që dua ta potencoj është ceremonia e diplomimit. Arsyeja pse kjo ngjarje ka aq rëndësi për mua, është sepse kjo ceremoni bëri mbylljen e një angazhimi intensiv për tre vite me radhë, dhe i dha një përmbyllje madhështore studimeve.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Rexhepi: Unë personalisht kam përfituar mjaft shumë nga programi i arkitekturës. I llojlojshmëria e lëndëve të ofruara në UBT më ka dhënë hapësirë për të eksperimentuar me idetë dhe synimet e mia për të ardhmen.

UBT Alumni: A keni përfituar nga mundësitë që ofron UBT për udhëtime studimore, studime jashtë vendit përmes UBT-së, internship apo forma të tjera të angazhimit?

Rexhepi: Në vitin e parë kemi pasur një vizitë në disa fabrika në Kosovës, ku unë si student kam parë për së afërmi se si prodhohen elementet të cilat ne i përdorim në projektet tona. Gjithashtu, kemi pasur edhe vizita jashtë vendit ku fatkeqësisht unë nuk kam mundur të shkoj për shkak të disa angazhimeve të tjera, por në bazë të informatave nga student e tjerët, ajo për ta ka qenë një për-



vojë shumë e mirë.

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?

Rexhepi: Duke pasur mësimdhënës të cilët asnjëherë nuk kanë kursyer dijen e tyre për ne, dhe me një përkushtim timin të madh ndaj profesionit, nuk ka qenë aspak e vështirë që të arrihen rezultate të larta. Kur studenti përkushtohet për profesionin që ka zgjedhur dhe me një mësimdhënie cilësore, atëherë nuk është aspak e vështirë të arrihen rezultate të mira.

UBT Alumni: A jeni duke punuar pas studimeve dhe ku?

Rexhepi: Unë jam duke punuar në kompaninë e familjes sime "Euroing" nga Fushë Kosova, e cila merret kryesisht me ndërtim. Një nga projektet e kësaj kompanie që dua ta veçoj është realizimi i njërit prej objekteve të UBT-së në kampus, ku unë si arkitekt pata rastin t'i vëzhgoj punët për së afërmi dhe të mbaj ditarin e punës. Marrja pjesë në realizimin e këtij projekti ka qenë ndjenjë e veçantë për mua, pasi që jam munduar që njohuritë që kam marrë në UBT t'i aplikoj në mënyrë sa më të mirë.

UBT Alumni: A jeni duke vazhduar studimet?

Rexhepi: Pasi që jam bindur se UBT ka një staf shumë të përgatitur me mësimdhënës vendorë, të huaj dhe mjaft cilësorë, kam vendosur që studimet e mia në nivelin Master t'i vazhdoj në UBT në drejtimin e arkitekturës.

Anyla Berisha

Anyla Berisha aktualisht është koordinatorë për drejtimin Bachelor në Fakultetin e Arkitekturës në UBT dhe tutore në lëndën "Projektim 1". Po kështu, vazhdon studimet në master në Arkitekturë në UBT, aty ku i mbaroi edhe studimet bachelor. Ajo ka filluar studimet në universitetin publik, për t'u transferuar pastaj për të vazhduar studimet në UBT, siç bënë edhe shumë kolegë e kolege të saj në Arkitekturë dhe në fakultetet e tjera të UBT-së.

Nga studimet bachelor ajo veçon lëndët e saj të preferuara - Projektim dhe Studio Dizajn, ndërsa thekson si përvojë shumë interesante angazhimin gjatë javës së Konferencës për Teknologji dhe Inovacione.

Anyla ishte pjesë e vizitës studimore të organizuar nga UBT në Bienalen e Arkitekturës në Venedik, që i ka lënë përshtypje të pashlyeshme.



Labëri Dakaj

Të jesh arkitekt nuk nënkupton mësimin shabllon, por ballafaqimin me realitetin tonë

Labëri Dakaj ka përfunduar studimet themelore në degën e Arkitekturës në UBT. Sot ajo i vazhdon studimet master në të njëjtën degë dhe në të njëjtin universitet.

Teksa flet për revistën "UBT Alumni", ajo thotë se arsyeja kyçe pse ka vendosur t'i fillojë studimet në këtë universitet ka qenë cilësia e një universiteti, në mënyrë të avancimit në lëmin që ka zgjedhur si profesion të saj, i cili do ta shoqërojë gjatë gjithë jetës.

Ajo thekson se, duke marrë parasysh se shkollimi në vendin tonë nuk është në shkallën e duhur, është e kënaqur që UBT ka arritur t'ia përmbushë kërkesat e saj për shkollim.

Rëndësi të madhe gjatë shkollimit trevjeçar u kam dhënë më shumë lëndëve profesionale. Gjë që vlen për t'u përmendur është praktika të cilën ne e kemi bërë gjatë vitit të tretë, e cila është më e nevojshme për arkitekturën, thekson Labëria, ndërsa shton se të jesh arkitekt nuk nënkupton mësimin shabllon, por ballafaqimin me realitetin tonë.

"UBT ofron mundësi të shumta. Mjafton dëshira e studentit për të arritur atë që dëshiron, por jo pa u angazhuar dhe pa punuar rreth saj", shton ajo.

Fillimi i studimeve ka qenë i vështirë, derisa jam ambientuar me programin dhe rrjedhën në universitet. Por, e kam pasur vullnetin e madh dhe dëshirën për të arritur rezultate të larta, thotë Labëria dhe shton: "Mentalisht jam duke vazhduar studimet Master prapë në UBT, si mundësia më e mirë në vend dhe në rajon. Edhe pse



mundësitë për të vazhduar më larg UBT nuk na i ka mohuar, por UBT ishte zgjidhja ime. Studimet janë kyçe për zhvillimin e një individi. Duhet zgjedhja e duhur se kujt t'ia besosh ato".

Pasi që i jam përkushtuar studimeve master, nuk jam duke punuar në një punë me orar të plotë, por kohë pas kohe merrem me ndonjë projekt në kompaninë "Euro Building" në Prishtinë, përfundon Labëri Dakaj.

Albina Vuthi

Studimet në arkitekturë, një eksperiencë unike

Arkitektura ishte dhe vazhdon të mbetet një drejtim shumë i rëndësishëm në jetën dhe karrierën e studentes Albina Vuthi. Ajo ka mbaruar studimet e arkitekturës në UBT dhe veçon dizajn enterierin, kreativitetin e studio dizajnit si fusha të cilat i kanë zgjuar më shumë interes gjatë kohës së studimeve.

Tek flet për periudhën e studimeve, ajo thotë se "në përgjithësi, çdo ditë në universitet karakterizohet me ngjarje interesante dhe të rëndësishme dhe e gjithë periudha e studimeve ka qenë shumë e veçantë dhe eksperiencë unike".

"Me përfundimin e studimeve e kam realizuar ëndrrën time të bëhem arkekte dhe në të ardhmen e afërt pres të me sjell ende suksese të radhës", shprehet Vuthi, e cila ka aplikuar për studime master jashtë vendit.

Ajo shprehet shumë e kënaqur me punën dhe përkushtimin e saj gjatë periudhës së studimeve dhe thekson se ajo që i ndihmuar ka qenë pasioni që ka për arkitekturën.



Nexhmija Nuza

Vizitat studimore, një përvojë e paharrueshme

Programet dhe ligjëruesit në UBT kanë qenë shtysa kryesore që e kanë shtyrë Nexhmije Nuzën të regjistrohet në Fakultetin e Arkitekturës në UBT pas përfundimit të shkollës së mesme.

E gjatë studimeve, ajo thotë se, pa dashur t'i ndajë asnjërin prej lëndëve, pasi të gjitha e kanë pasur rëndësinë e tyre, megjithatë përshtypje më të mëdha i kanë lënë lëndët Projektim, Konstrukione dhe Studio.

Gjatë kësaj kohe, përshtypje më të rëndësishme i ka lënë pjesëmarrja Konferencën e organizuar nga UBT me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, ku ajo ka pasur mundësi të njoftohet me profesorë të huaj të lëmit të Arkitekturës, si dhe të përfitojë njohuri të shumta. Por, përvoja më interesante për të ka qenë vizita studimore e organizuar nga UBT, gjatë së cilës ajo së bashku me studentë të tjerë kanë vizituar Dubrovnikun në Kroacia, Lubjanë në Slloveni, Venecianë në Itali dhe Vjenën në Austri.

“Nga këto vizita kemi mësuar shumë për historinë dhe arkitekturën e këtyre vendeve”, shprehet ajo.

Ajo ka qenë edhe në një vizitë tjetër. “Kemi qenë në vizitë në Stamboll disa ditë, ku kemi vizituar panairin e materialeve, i cili organizohet çdo vit dhe kemi punuar një uorkshop me studentët e Fakultetit “Mimar Sinan”, një ndër

fakultet më të mira të Arkitekturës, ku edhe jemi shpërblyer me certifikata për pjesëmarrje”, thekson Nuza.

E kur flet për rezultatet e larta që ka arritur gjatë studimeve, ajo shprehet: “Duke pasur parasysh që unë në shkollën e mesme kam qenë në gjimnaz, kur i kam filluar studimet më është dashur të filloj nga zeroja. Mirëpo, me përkushtim të madh dhe me ndihmën e profesorëve, të cilët asnjëherë nuk kanë hezituar të na japin ndihmën e tyre, kam arritur këtu ku jam sot”.

Nexhmija Nuza sot është e angazhuar në zyrë projektuese “Centimetri”, që është një shoqëri arkitektësh, inxhinierësh dhe dizajnerësh që i ka fillimet e saj në vitin 2004 dhe që, e organizuar në një mënyrë shumë bashkëkohore si në ide, projekte, staf, menaxhim, ka krijuar një filozofi krejtësisht të re të arkitekturës në Kosovë.



Gonxhe Çausi

Të jesh pjesë e UBT-së është nder dhe privilegj


“Pasi që kam mbaruar shkollën e mesme të lartë, qëllimi im kishte qenë të studioja në një Universitet ku profesorët do të jenë të rregullt në mbarëvajtjen e ligjërës, të kem qasje më të lehtë në konsultimin, pra forma e komunikimit të jetë me e lehtë në mes tyre për një problem të caktuar në të cilin do të hasja gjatë studimeve të mia, numri i studentëve të jetë në përputhje me klasën në mënyrë që ligjërata të jetë më e kuptueshme për të gjithë njësoj. Të gjitha këto për fillim kanë qenë si një lloj shtytës mjaft i lartë të më bëj të studioj në UBT pasi që për mua kanë mjaft rëndësi kushtet të cilat ofron universiteti për një studim më cilësor ku rëndësi i jepet cilësisë e jo numrit të studentëve”, thekson Gonxhe Çausi, e cila në UBT ka mbaruar studimet në Fakultetin për Menaxhim, Biznes dhe Ekonomi dhe është duke i vazhduar studimet në nivelin master, po në UBT.

Duke kujtuar ngjarjet e rëndësishme nga periudha e studimeve, ajo shprehet: “Ishte momenti kur e kuptova që isha në top 10-shen e studentëve me të mirë të gjeneratës sime. Ishte një ndjenjë mjaft e mirë dhe mjaft domethënëse për mua dhe si dhe për prindërit e mi”. Derisa rendit disa nga fushat e saj më të preferuara të studimit, ku hyjnë menaxhimi financiar, statistika, menax-

himi i projekteve, mikro dhe makroekonomia e të tjera, Çausi se nga UBT ka përfituar cilësi të lartë të ligjërimit nga një kuadër mjaft i kualifikuar kombëtar dhe ndërkombëtar.

“Kam qenë e involvuar në forma të tjera të angazhimit. Kam qenë e ftuar për ta përfaqësuar UBT-në në Panairin e Edukimit, i cili është mbajtur vitin që e lamë pas, si dhe e kam promovuar UBT-në në qytetin tim, Mitrovicën. Gjithë këto të japin një nder dhe privilegj të jesh kontribuues për UBT-në”, shprehet më tej ajo.

Por, si i ka arritur rezultatet e larta gjatë studimeve? “Mjafton të kesh vizion për atë se çfarë dëshiron të arrish gjatë studimeve. E gjithë kjo arrihet me një përkushtim të vazhdueshëm dhe vullnet të madh në arritjen e synimeve. Kjo nuk do të ishte e mundur pa ndihmën e profesorëve të UBT-së dhe pa mbështetjen e tyre”.



Tirana Selimi

Me punë sistematike arrihet gjithnjë rezultat

Tirana Selimi i ka përfunduar studimet bachelor në Arkitekturë në UBT dhe po i vazhdon këtu edhe studimet master, duke ndjekur traditën e familjes së saj, që është familje inxhinierësh dhe arkitektësh.

E për realizimin e këtij synimi, ajo ka gjetur në UBT programin e duhur dhe stafin profesional. Lënda më e preferuara ka qenë Studio e dizajnit, me Prof. Binak Beqaj, ku janë zhvilluar projekte të ndryshme për dy vite, të cilat kanë qenë një sfidë për të dhe kolegët e saj si arkitektë të rinj.

Si ngjarje të rëndësishme, ajo veçon udhëtimin studimor në Evropë, vizitat në universitetet e ndryshme dhe uorkshopet e zhvilluara gjatë këtyre vizitave.

“Nga programi i studimit në UBT unë kam përfituar ngritje profesionale dhe mund të them se kam fituar njohuri të mjaftueshme për të bërë punën e një arkitekti”, shprehet Selimi.

Ajo numëron përvojat e saj, si në vizita, uorshope e internship, që i ka realizuar gjatë studimeve në UBT:

- Internship gjatë muajit gusht 2012 në Meier-Koop/Zurich - si praktikante e arkitekturës;
- Internship gjatë vitit 2013 në Alping - studio e arkitekturës në Prishtinë;
- Internship gjatë vitit 2014 në Enggroup - studio e arkitekturës në Prishtinë;

- Uorkshop - Connecting Dots në Stamboll, maj 2014;

- Vizita studimore në Universitetin Teknik të Vjenës, vizita studimore në Universitetin “Mimar Sinan” dhe atë “Kadir Has” në Stamboll;

- Udhëtimet studimore në Dubrovnik, Venecia, Rjekë, Lubjanë, Vjenë, Stamboll etj.



Tirana arritjen e rezultateve të mira ia dedikon punës sistematike, vijueshmërisë së rregullt në ligjërata dhe në ushtrime, konsultimeve të rregullta me profesorët dhe asistentët e UBT-së, si dhe mbështetjes së vazhdueshme profesionale nga familja.

Me të përfunduar të studimeve, ajo është punësuar si arkitekte në kompaninë “ENGGROUP” në Prishtinë, ku aktivitetet e saj kanë të bëjnë me menaxhimin e aktiviteteve të firmës, koordinimin e aktiviteteve inxhinierike të fazave të ndryshme të projekteve. Njëkohësisht merret me projektim, revidim të projekteve në studio.

Diellëza Xhemaili

Projektet e punuara në UBT e bënë një hulumtuese të mirë

“Të gjitha projektet e bëra kanë qenë një mësim shumë i mirë për mua, të cilat edhe më kanë bërë që të jem aktive dhe të bëhem një hulumtuese e mirë sot”, thekson Diellëza

“Pasi kreu shkollën e mesme vendosa të regjistroj dy universitete, të cilat kanë drejtime të kundërta, pasi që isha e interesuar të marrë sa më shumë dije dhe të pajisem me njohuri të shumta nga disa fusha të ndryshme. Andaj, vendosa të regjistrohem në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, në drejtimin e Komunikacionit, dhe pastaj, duke bërë shumë hulumtime në universitete të ndryshme në Kosovë, vendosa të regjistrohem edhe në Universitetin për Biznes dhe Teknologji”, shprehet Diellëza Xhemaili, e diplomuar në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT.

Ajo është duke i vazhduar prapë studimet në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, në nivelin master në drejtimin Menaxhimi i Prokurimit Publik dhe Logjistikës.

“Pasi gjatë studimeve të mia jam ndarë e kënaqur në këtë universitet, unë prapë mendova t’i vazhdoj edhe studimet master dhe gjithsesi shpresoj që edhe gjatë kësaj kohe do të kaloj mirë me ju”, thotë Xhemaili.

Derisa lëndët e saj të preferuara kanë qenë matematika, mikroekonomia, makroekonomia, marketingu e të tjera, ajo thotë se të gjitha angazhimet e saj në UBT kanë qenë të rëndësishme gjatë periudhës së studimeve.

“Të gjitha projektet e bëra kanë qenë një mësim shumë i mirë për mua, të cilat edhe më kanë bërë që të jem aktive dhe të bëhem një hulumtuese e mirë sot”, thekson Diellëza dhe shton: “Nga programi i studimit në UBT kam marrë njohuri të shumta dhe sot ato jam duke i praktikuar edhe në jetën time dhe në punë”.

Diellëza gjatë tërë kohës së studimeve ka qenë edhe duke punuar, kështu që, me gjithë mundësitë e ofruara, nuk ka marrë pjesë në udhëtimet studimore që i organizon UBT

Ajo sot është duke punuar në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), në pozitën e hulumtueses në monitorimin e prokurimit publik të komunave. Institucioni ku ajo punon, KDI bën monitorimin e parlamentit, monitorimin e prokurimit publik, merret me qeverisjen lokale duke mbështetur zhvillimin e demokracisë, duke fuqizuar qytetarët dhe sektorin joqeveritar për të ndikuar në rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve qytetare dhe përmirësimit të efikasitetit të këtyre institucioneve përmes pjesëmarrjes së qytetareve në vendimarrje



Ish-studenti i UBT-së, Kemajl Zariqi pronar dhe drejtues i Fabrikës së Veglave në Ferizaj

Kemajl Zariqi ka studiuar në UBT në periudhën 2006-2009, në drejtimin Administrim Biznesi. Ai sot udhëheq Fabrikën e Veglave në Ferizaj, që ka shënuar së fundi suksese të shënuara, duke kthyer namin e dikurshëm që ajo kishte.

“Pas privatizimit qëllimi ynë kryesor ishte që ne ta vazhdojmë veprimtarinë e njëjtë që ka ushtruar fabrika deri atëherë. Qytetarët e Ferizajt e kanë vlerësuar si një aset të veçantë me mburrje dhe krenari gjithnjë, se ne kemi një fabrikë të tillë në qytetin tonë. Janë nevojitur shumë investime të reja si nga teknika dhe teknologjia po ashtu edhe nga stafi punues, i cili kërkon një specializim shumë profesional. Për këtë janë dashur shumë investime, kohë dhe, mbi të gjitha, përkushtim. Falë përkushtimit dhe kualitetit i cili në profilin e veprimtarisë sonë nuk ka kompromis, sot kompania jone ka arritur që ta kthejë atë imazh të vërtetë të fabrikës, duke kaluar kufijtë e shtetit dhe rajonit”, thekson Zariqi, kompania e të cilit operon me një numër prej 45 punëtorësh, të profesioneve dhe profileve të ndryshme.

“Ne si kompani synim kryesor kemi investimin në resurset humane tek gjenerata e re, e cila është kapitali ynë më i madh në vend. Andaj, në një të ardhme të afërt ne pretendojmë që numrin e punëtorëve ta rrisim edhe më shumë”, shton ai.

“Nga studimet në UBT unë kam mësuar shumë dhe nga ajo kohë jemi pak më zyrtarë në administrimin e kohës së punës. Pastaj, analizat e tregut, planifikimi, zhvillimi, impakti i faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm për zhvillimin e biznesit. Sjellja në organizatë, politikat fiskale, politikat monetare, makro dhe mikro ekonomia, ndikimi që ka ajo për zhvillimet e vendit, mbi të gjitha jam shumë më i vetëdijshëm për GDP-në”, thotë ai, duke folur për përvojën e studimeve në UBT.

Kompania që drejton z.Zariqi finalizon produkte edhe për kompani të mëdha edhe jashtë Kosovës. Produktet që prodhohen për tregun e jashtëm janë produkte finale, të cilat vetëm montohen apo edhe ka raste kur disa makina shkojnë komplet të montuara dhe vetëm lidhet komunikimi me makineritë e tjera dhe bëhen pjese e sistemit të prodhimit për destinacione të caktuara.

“Aktualisht, kooperimin më të madh e kemi me firmën “VALMET” nga Suedie, me të cilët i kontraktujmë produktet që i ceka me lart. Ato paketohen dhe nisen në destinacione të caktuara ku ata i shesin. Kemi pasur raste kur ato shkojnë për Brazil, Indonezi etj. Kuptohet, makinat që shkojnë në destinacione të caktuara ata vijnë dhe i kontrollojnë te ne dhe bëjnë pranimin teknik te ne. Kurse, ato që shkojnë në Suedi kontrollohen atje në firmën “VALMET”, thotë ai, teksa përmend edhe kompanitë e tjera me të cilat bashkëpunon kompania e tij.

“Firma tjetër nga Gjermania është “HEBO Maschinenfabrik”, për të cilët prodhojmë disa ventilë të shisheve të gazit me presion të lartë. Ne bëjmë vetëm përpunimin e

brendshëm makinerik, ventilët si repromaterial të një kualiteti të lartë vijnë nga vet firma dhe të njëjtit, pas përpunimit makinerik, kthehen në Gjermani.

Bashkëpunojmë edhe me firmën “KELER”, një firmë që furnizon “McDonald’s”-in me inventarë dhe hotele

të ndryshme. Këto produkte i finalizojmë në bashkëpunim me dy firma kosovare. Ne e bëjmë prodhimin, “Cadi kompani” nga Ferizaj i bën elementet e plastikës, kurse firma “AB Coating ShPK” nga Istogu e bën plastifikimin me ngjyra të firmës “Aksa Nobel” nga Italia. Ndërsa bashkëpunim dhe prodhim të pjesëve rezervë bëjmë edhe për Zvicër. Është firma “KADOLLI”, pronë e një shqiptari, që bën mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave bujqësore”, thotë z.Zariqi.

Ai flet për vështirësitë me të cilat përballet biznesi që drejton.

Pika më kritike është të krijosh një staf profesional, kur dihet fakti se profesionalizimi te ne ka ngecur që nga koha e dëbimit nga shkollat, universiteti, largimi masiv nga puna, thekson Zariqi, për të shtuar: “Ka shumë biznese në Kosovë që kanë angazhuar ekspertë nga jashtë dhe besoni se ata marrin paga më të mëdha se në Gjermani. Për dallim nga këto biznese, ne kemi trashëguar disa ekspertë shumë të mirë, të cilët janë rritur dhe janë plakur në fabrikë një jetë njeriu me eksperiencë 40-vjeçare. Kontributi e tyre është i barabartë me ekzistencën e fabrikës dhe suksesi është një kontribut i përbashkët pa përjashtim. Për këtë ne jemi shumë mirënjohës”, thotë ai.

Ai ka një porosi edhe për ata që i bëjnë politikat. “Duhet të ndryshojë mentaliteti dhe personeli që është pjesë e institucioneve duhet ta kuptojë se është normale që biznesi privat të zhvillohet pa nxjerrë shumë barriera sipas tekeve dhe dëshirave të tyre. Të krijojë një klimë biznesi me mundësi të barabarta pa përjashtime. Shumica e bizneseve të huaja në Kosovë janë të përkëdhelura, vetëm për faktin se janë të huaj. Për këtë janë fajtoreset vetëm institucionet...”, thekson Zariqi.

“Qasja e institucioneve shtetërore ndaj bizneseve duhet të ndryshojë po ashtu edhe në lehtësimin e të bërit biznes për kompanitë private. Duhet të ketë lehtësira në politikat fiskale, lehtësira në fushën e financimit, do të thotë në krijimin e kushteve në politikat fiskale për investime të reja dhe jo në ngritjen e normave të interesit, të cilat janë më të lartat në Evropë”.



Kamer Borovci

Kamer Borovci drejtues i kompanisë së suksesshme “Brickos SHPK”

Kamer Borovci ka diplomuar në ekonomi dhe biznes në UBT, ndërsa tash me familjen e tij janë pronarë të fabrikës “Brickos SHPK”, që merret me prodhimin e elementeve nga argjila, e cila gjendet në komunën e Kamenicës, skaj rrugës magjistrale Gjilan-Bujanovc.

Kompania “Brickos” është vazhdimësi e kompanisë “V.Borovci”, e themeluar në vitin 1990. Në kuadër të saj, veprimtarinë e zhvillon fabrika për prodhimin e elementeve nga argjila, e cila është komercializuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit në maj të vitit 2002 dhe pas 6 muajsh investimesh fabrika ka filluar prodhimin e blloqeve të ndryshme për treg. Në vitin 2008 kompania “V.Borovci” e ka privatizuar fabrikën me spin-of special, duke i përmbushur të gjitha investimet e parapara dhe merret si storie e suksesshme e komercializimit dhe më vonë privatizimit. Në vitin 2008, në kuadër të fabrikës ka filluar ndërtimi i repartit të ri, i cili ka përfunduar në vitin 2010 dhe sot është duke prodhuar blloqe për tregun e Kosovës. Teknologjia që e disponon sot fabrika e blloqeve është në hap me kohën. Z.Borovci është një nga studentët e shumtë të UBT-së, që janë treguar mjaft të suksesshëm në biznesin e tyre. Dijeve të mëhershme ai ua ka shtuar edhe përvojën e studimeve në UBT, të cilat i ka nisur në vitin akademik 2006/2007, ndërsa i ka përfunduar në vitin 2010.

“Unë kam përfituar shumë nga studimet në UBT, sidomos në metodat bashkëkohore të menaxhimit në një ekonomi globale. Studimi në UBT ka qenë një përvojë shumë e mirë dhe një ndryshim i madh nga studimet që i kisha ndjekur më herët në UP. Studimet në UBT, pos të tjerave, më kanë ndihmuar shumë në menaxhimin e burimeve njerëzore, si aseti më i çmueshëm i një kompanie”, thotë z.Borovci.

Kompania që drejton z.Borovci ka edhe bashkëpunim ndërkombëtar, të cilin ai, në një ekonomi globale, e quan të pashmangshëm. “Shumë projekte në kuadër të kompanisë tonë janë ekzekutuar nga kompanitë ndërkombëtare, disa projekte janë filluar dhe mbaruar bashkërisht. Bashkëpunimi më i madh është në kuadër të teknologjisë, në mënyrë që të jemi në hap me zhvillimet nga lëmi i kësaj industrie në regjion dhe më gjerë”, thotë z.Borovci.

Por, kompania që drejton ai, përballat edhe me shumë probleme e sfida, sikur të shumë prej bizneseve në kohën tonë.

Sipas tij, sot sfida në industrinë e prodhimit në Kosovë janë burimet njerëzore, të cilave u mungon kompetenca dhe trajnimet. Sfidë në vete janë edhe ligjet, të cilat janë



kopjuar nga vendet evropiane dhe nuk i përshtaten realitetit në Kosovë. Politikat qeveritare në Kosovë nuk janë në favor të prodhuesve vendorë, me këto politika stimulohen prodhuesit jashtë Kosovës, kurse diskriminohen prodhuesit vendorë.

Ai ka një vërejtje të madhe. Thotë se të udhëheqësh një biznes prodhues të suksesshëm në Kosovë është shumë e vështirë. “Shoqëria në përgjithësi, me pak përjashtime, nuk e përkrah prodhimin vendor. Prodhuesit në Kosovë përballen me vështirësi dhe probleme të cilat nuk mund t'i zgjidhin vet, si problemi i furnizimit me energji elektrike, mungesa e burimeve njerëzore të trajnuara, diskriminimi i prodhuesve vendorë në krahasim me prodhuesit e regjionit”, thekson Borovci.

Por, çka duhet ndryshuar në qëndrimin e institucioneve shtetërore ndaj biznesit vendor. Borovci e ka zgjidhjen: “Së pari të krijohet një ambient për prodhuesit vendorë, të hiqet dogana për lëndët e para dhe makineritë që përdoren në procesin e prodhimit, të kenë përparësi prodhimet vendore në investimet të cilat bëhet nga buxheti i Kosovës, ligjet të jenë në përputhje me realitetin në Kosovë, pagat në sektorin publik nuk guxojnë të jenë shumë më të larta se në sektorin privat, pasi rritja ekonomike vjen nga sektori privat, të krijohen politika ekonomike që tërheqin investime nga jashtë në mënyrë që rritja ekonomike të jetë më e madhe”.

Fisnik Dragusha

Suksesi vjen tek ata që janë shumë të zënë duke e kërkuar atë

Fisnik Dragusha ka studiuar në gjeneratën e parë në UBT, në drejtimin Biznes Menaxhment. E ka pasur në fokus të veçantë marketingun dhe shitjen.

“Karriera ime në UBT ka filluar si çdo student me ligjërata në gjuhën angleze. Në fillim të vitit të dytë kam qenë student i parë që jam punësuar në Universitet pas shumë aktiviteteve të zhvilluara në të cilat kam marrë pjesë. Puna ime ka qenë e lidhur me një projekt që Universiteti e ka pasur bashkë me Odën Ekonomike të Austrisë (departament që merret me trajnime). Puna ime ka qenë koordinimi i këtyre trajnimeve veçanërisht të menaxhmentit, kam qenë pjesë në exchange në Universitetin e Vjenës. Magjistraturën e kam përfunduar në Londër, pastaj jam punësuar në organizatën ndërkombëtare USAID në sektorin e zhvillimit ekonomik me një projekt 4-vjeçar. Jam specializuar në sektorin e turizmit dhe tash jam drejtor në VAS GROUP që është një kompani regjionale që merret me turizëm”, thekson Dragusha.

Tani Dragusha është drejtor menaxhues në “VAS TOUR TRADE”, që ka 135 punëtorë. Ai e menaxhon zyrën e Kosovës. Janë 120 partnerë që bëjnë shitje në agjenci. Duke përkujtuar përcaktimin për të studiuar në UBT, ai thekson se, megjithëse ishte pranuar në një universitet tjetër, një takim me rektorin Hajrizi ia ka bërë të qartë

konceptin e UBT-së dhe ai ka vendosur pa hezitim për t'u bërë pjesë e UBT-së. “Nuk kam gabuar, sepse kam arritur shumë. Forma e punës dhe niveli i profesorëve ka qenë shumë i lartë”, thekson ai.

Z.Dragusha thotë se UBT i ka ofruar mundësi të mira studimi. “Ka pasur raste që e kemi marrë një çelës të një salle, projektorin dhe laptopin, ndoshta ka ikur mesnata e ne ishim duke punuar, diskutuar për provime dhe tema të ndryshme”, kujton ai.

Derisa thekson se në jetë dhe në përditshmëri çmon korrektësinë, sinjeritetin dhe punën, ai flet së dita e tij e punës kalon me takime dhe planifikime për shitjen e produkteve. “Shërbimi ynë është i padukshëm, ngase ofrojmë pushime, relaks dhe ta shesësh qejfin në një treg si ai i Kosovës është vështirë. Pastaj pjesa më kryesore është aranzhimi i udhëtimit”, thotë ai.

“Shfrytëzoheni universitetin maksimalisht, unë kam përjetuar shumë stile të jetës edhe në Londër, Amerikë, Vjenë. Bota është dinamike, duhet të bëheni të gjithanshëm, jo të fokusoheni vetëm në një drejtim. Nga pak njohuri për secilën sferë, shfrytëzoni resurset që ofron UBT-ja dhe kërkonin më shumë nga ai”, shprehet Fisnik Dragusha.

A.Zeneli

Dr.Anita Mirijamdotter ligjëroi para studentëve të UBT-së

Në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare, në UBT këtë javë ishte për ligjërim Dr.Anita Mirijamdotter nga Universiteti Linnaeus i Suedisë, e cila mbajti një cikël ligjëratash me studentët e nivelit master në drejtimin Sistemet e Informacionit.

Gjatë ditës së sotme, ligjëratën e saj me titull “Analiza, dizajni dhe modeli i sistemeve të informacionit”, e përcollën një numër i madh i studentëve, të cilët u shprehën shumë të kënaqur me materie e shtjelluar nga zonja Mirijamdotter.

Ata gjithashtu theksuan faktin se përmes sjelljes së profesorëve nga universitetet prestigjioze në UBT, u krijohen mundësi të shumta të mësimi të përvojave dhe dijeve të reja.

Gjithashtu, dr.Anita Mirijamdotter u prit në një takim nga rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi. Në takim u diskutua për bashkëpunimin e deritashëm mes UBT-së dhe Universitetit Linnaeus, i cili është i shtrirë në disa fusha.

Po kështu, u diskutua për bashkëpunimin në të ardhmen, në kuadër të projektit Erasmus +, projekte të përbashkëta hulumtuese dhe zhvillime të tjera, sic është shkolla verore e të tjera.

Dr. Anita Mirijamdotter është profesore e Informatikës në Universitetin Linnaeus, Suedi, që nga viti 2008, ku është edhe Shefe e Departamentit të Informatikës. Gjatë

periudhës 2010-2012 ajo ishte prodekane e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Inxhinierisë, si dhe kryesoi Komitetin e Fakultetit dhe Bordin për Emërime Akademike. Ajo ka mbikëqyrur një numër të madhe studentësh të doktoratës. Gjithashtu, dr. Mirijamdotter është paraqitur në një numër të madh konferencash ndërkombëtare, si dhe ka një numër të madh publikimesh në revista shkencore.



Arlind Nushi

Studenti i UBT-së themelues i kompanisë prestigjioze

UBT Alumni: Si keni vendosur të studioni në UBT?

Nushi: Pasioni për zhvillimin e ueb-faqeve dhe programeve softuerike më ka shtyrë që të kërkoj avancim dhe studim më të thellë në këtë lëmi pas shkollimit të mesëm. Pas shqyrtimit të kurikulave të disa fakulteteve, UBT ka qenë institucioni më i përshtatshëm për mua në realizimin e ëndrrës sime në këtë fushë.

UBT Alumni: Cilat kanë qenë lëndët e juaja të preferuara?

Nushi: Të gjitha lëndët e kurikulës kanë pasur rëndësinë e tyre, por theks të veçantë për mua kanë pasur lëndët e programimit dhe të matematikës, të cilat ndërlidhen ngushtë me njëra-tjetrën dhe bëjnë "magjinë".

UBT Alumni: A mund të ndani me ne ndonjë ngjarje të rëndësishme nga periudha e studimeve?

Nushi: E gjithë rrjedha e studimeve të mia në UBT ka përfshirë risi dhe ngjarje të rëndësishme, e me kalimin e kohës sfidat e pamundura për mua në atë kohë u bënë të realizueshme nga semestri në semestër.

Njëra prej këtyre ngjarjeve është kur unë kam publikuar produktin e parë në "Envato Marketplace", platformë e nivelit internacional me mbi 3 milionë përdorues në atë kohë.

UBT Alumni: Sa keni përfituar nga programet e studimit në UBT?

Nushi: Çdo lëndë nga kurikula e studimeve ka bërë që të mësojë gjëra të reja dhe të informohem me subjektet përkatëse, të cilat më kanë orientuar në ngritjen profesionale.

UBT Alumni: A keni përfituar nga mundësitë që ofron UBT për udhëtime studimore, studime jashtë vendit përmes UBT-së, internship apo forma të tjera të angazhimit?

Nushi: Pothuajse gjatë gjithë kohës së studimeve kam qenë vullnetarisht i angazhuar në programim të ueb-faqeve dhe softuerëve të ndryshëm personalë dhe gru-



porë, ku si mentor i kam pasur disa nga profesorët e UBT-së, të cilët më ofronin ide për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Kjo ka qenë qasja ime gjatë studimeve dhe më ka shërbyer si një lloj praktike-internshipi.

UBT Alumni: Ju keni treguar rezultate shumë të mira gjatë studimeve. Si e keni arritur këtë?


Nushi: Vendosmëria në synimin tim dhe dashuria për profesionin kanë qenë elementet kryesore në realizimin e këtyre rezultateve gjatë studimeve. Këtyre dy komponentëve kryesorë iu shtohen kushtet e studimit si dhe niveli i lartë stafit i akademik.

UBT Alumni: A jeni duke punuar pas studimeve dhe ku?

Nushi: Po, ende pa i përfunduar studimet kam pasur oferta të ndryshme për punë në profesionin tim dhe vlen të ceket që në çdo institucion apo kompani ku kam aplikuar prioritet të madh kanë pasur studentët e UBT-së. Pas përvojës disavjeçare në dy kompanitë ku kam punuar, si PC World Albania dhe Trokit Agency Creative, tash drejtoj biznesin tim personal dhe jam i vetëpunësuar. Tash jam bashkëthemelues (ang. co-founder) i agjencisë Laborator Creative, e cila si veprimtari kryesor ka dizajnimin dhe zhvillimin e ueb-faqeve për WordPress, aplikacione softuerike (back-end dhe front-end) dhe skripta të ndryshme të ueb-faqeve në platformën "Envato Marketplace" ose më saktësisht në nënfaqet ThemeForest dhe CodeCanyon dhe operon në tregun global.

Është e rëndësishme të ceket që këtë kompani e kam themeluar me një shok i cili po ashtu është student i UBT-së dhe quhet Art Ramadani. Së bashku kemi arritur që të publikojmë 12 dizajne të ueb-faqeve të platformave të ndryshme si WordPress, admin panels, jQuery mobile dhe të tjera, dhe po ashtu kemi publikuar 12 skripta për përdorime të ndryshme në ueb.

Si autor në "Envato Marketplace" kemi arritur një numër të konsiderueshëm të shitjeve si dhe kemi pranuar oferta të shumta për bashkëpunim nga kompani me renome botërore e institucione të ndryshme si MIT (Massachusetts Institute of Technology) dhe kompania që kam themeluar është në rritje e sipër.



UBT organizoi punëtori me ekspertë ndërkombëtarë për themelimin e inkubatorit të biznesit

Në kuadër të projektit për Inkubatorin Virtual të Kosovës dhe Qendrën për fillimin e bizneseve të reja, UBT ka organizuar një varg punëtorish me ekspertë të ndryshëm ndërkombëtarë të kësaj fushe. George Lantzas ishte eksperti i radhës i cili mori pjesë në punëtorinë e radhës, ku janë diskutuar një varg temash me interes. Temë e veçantë e punëtorisë ishte ndërlidhja e modelit të UBT me praktikatat e mira ndërkombëtare për funksionimin e inkubatorit brenda UBT-së, jetësimi i tij dhe përshtatja sa më e mirë me rrethanat në Kosovë, duke bërë që ky inkubator të jetë përkrahës i ndërmarrësve dhe ideatorëve të rinj dhe të rezultojë me sukses. Ky inkubator planifikohet të ketë një hapësirë të veten përbrenda UBT-së me pajisje përcjellëse dhe hapësirë pune. Ai do të jetë i gatshëm brenda 30 ditëve të ardhshme, ku edhe do të hapet konkursi për studentët dhe alumin e UBT-së që të aplikojnë dhe të sjellin idetë e



tyre.

Inkubatori i biznesit është projekt i përbashkët i UBT-së dhe Ambasadës së SHBA në Kosovë. Gjithashtu, në kuadër të inkubatorit të biznesit do të publikohet një magazinë mbi ndërmarrësinë, me disa edicione brenda vitit.

Certifikim ndërkombëtar për menaxhimin e projekteve

Prishtinë, 25 mars. - Në kuadër të ligjëratave tematike dhe bashkëbisedimeve me qytetarë, që po mbahen në UBT, të martën u mbajt Sesioni Informativ për procesin dhe benefitet e certifikimit.

Qëllimi i takimit ishte njoftimi për certifikime ndërkombëtare për menaxhimin e projekteve sipas standardeve të organizatës ndërkombëtare me bazë në Zvicër IPMA (International Project Management Association).

Rektori i UBT-së, dr.Edmond Hajrizi e hapi këtë takim, duke i falënderuar të pranishmit, të cilët edhe kësaj radhe ishin të shumtë. Ai foli për rëndësinë që Kosova ka në menaxhime të projektit si dhe mundësitë që i janë ofruar vendit për këtë fushë.

“Kosova ka të drejta të barabarta, njësoj sikur çdo vend tjetër në botë, edhe sikur Gjermania, Amerika, Anglia, Australia, Holanda dhe fati jonë i mirë është që të gjitha kriteret e njëjta, përmbajtje dhe informacione të njëjta janë edhe në gjuhën shqipe, pra nuk ka nevojë në gjuhë të tjera. Është një lehtësim më i madh”, tha z. Hajrizi.

Ai shtoi se është i interesuar që bashkarisht shoqërinë ta ngrisin në nivelin më të lartë profesional të menaxhimit të projektit. Sipas tij njerëzit në përgjithësi nuk i njohin projektet, ose njohin disa segmente të projektit por jo edhe tërësinë dhe në këtë mënyrë kanë të bëjnë me jokuskses, me humbje dhe njëra nga efektet është që ta ngrisin vetëdijen dhe kompetencën në menaxhimin e projekteve. Janë dy fusha në të cilat ky program u ofron studentëve dhe të gjithë të interesuarve: Informimi, trajnimi & ngritja e kapacitetit; Certifikimi.

Rektori i UBT-së u shpreh se objektivi i UBT-së është që

certifikimi të mos jetë i shtrenjtë. Kjo do të thotë të kenë mundësi sa më shumë kandidatë të certifikohen dhe që të gjithë të kenë sukses.

“Ideja e

kësaj është se ne duam që, me një çmim sa më të arsyeshëm, të arrijmë efektin e njëjtë sikur në vendet e tjera dhe e gjithë kjo bëhet për të arritur një vlerësim profesional dhe ju shërben si pjesë të karrierës”, theksoi ndër të tjera rektori Hajrizi.

Certifikimet janë të dy niveleve:

Certifikimi në nivelin D – Personat që me sukses menaxhojnë dhe marrin pjesë në projekte. Niveli i parë i kompetencës, kjo bëhet me provim me gojë dhe me shkrim. Certifikimi në nivelin C – Personat që, përveç provimit me shkrim dhe me gojë, u duhet edhe një prezantim i një dokumentimi të projektit që ai e ka punuar më herët dhe në fund merr një nivel më të lartë.

Ka edhe certifikim për nivelin më të lartë, për ata që punojnë në menaxhimin e projekteve komplekse. Projekt kompleks quhet ai projekt që ka mbi 5 milionë euro buxhet.



Meteorologjia aeronautike, pjesë e rëndësishme e operimeve në ANP-Kontrolli ajror “Adem Jashari”

Nga Sherif Gosalci

Meteorologjia është shkencë që merret me studimin e atmosferës së tokës, aplikimi i së cilës është analiza dhe parashikimi i motit. Meteorologjia aeronautike studion atmosferën, meqë operimet aeronautike afektohen dhe zhvillohen në atmosferë.

Kushtet atmosferike mund të paraqesin rrezik por edhe mund të ndihmojnë në realizimin e fluturimeve. Shtërngatat, turbulencat, ngricat, mjegulla, bora e breshëri janë disa nga rreziqet potenciale që hasen në fluturim.

Divizioni Meteorologjik është një nga katër divizionet operative, qenësore, për ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) - Kontrolli Ajror “Adem Jashari”. Divizioni Meteorologjik në ANP “Adem Jashari” është përgjegjës për vrojtimin dhe parashikimin e motit për nevoja të aviacionit dhe për të përgatitur të dhëna klimatologjike dhe statistikore të rëndësishme për planifikimin e operimeve aeronautike. Objektivi i Divizionit Meteorologjik është ofrimi i informatave të nevojshme dhe të domosdoshme meteorologjike aeronautike tek shfrytëzuesit aeronautikë, me qëllim të planifikimit të fluturimeve të rregullta dhe të sigurt.

Ky divizion menjëherë pas luftës në Kosovë (1999) ka filluar konsolidimin dhe profesionalizimin e stafit, përzgjedhja e të cilit është bërë menjëherë pas ardhjes së Forcave Ajrore Mbretërore Britanike (RAF) në Aeroportin e Prishtinës.

Në periudha të ndryshme, stafi i këtij divizioni është trajnuar dhe përgatitur profesionalisht në qendra të njohura ndërkombëtare në sferën e meteorologjisë aeronautike në Britani të Madhe, Francë, Islandë, Luksemburg, etj. Sot, duke iu falënderuar sistemeve që kemi në shfrytëzim, si ai për matjen e parametrave meteorologjikë – AWOS, për njoftimin e pilotëve – SADIS, për pranimin e imazheve dhe produkteve nga EUMETSAT (Organizata Evropiane për Eksplorimin e Imazheve Satelitore), sistemin e sondazhës - për matjen e parametrave meteorologjikë vertikalisht për qëllime të rritjes së efikasitetit në parashikim, si dhe stafit profesional që posedon Divizioni Meteorologjik i ANP-së është shembull i simotrave në rajon.

Gjithnjë duke përmbushur dhe respektuar kriteret dhe obligimet që rrjedhin nga organizatat ndërkombëtare ICAO (Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil) dhe WMO (Organizata Botërore e Meteorologjisë), sot Departamenti Meteorologjik ofron shërbime 24 orë pandërprerë dhe si rezultat i kësaj, niveli i sigurisë i operimeve për dhe nga ANPO “Adem Jashari” është i një standardi mjaft të lartë.

Për përmbushjen e këtyre të arriturave që u theksuan më lart, ky divizion përgatit dhe shpërndan këto produkte: METAR – raporte të vrojtimeve që pasqyrojnë kushtet aktuale të motit, TAF (parashikimet aeroportuale) –

parashikim i koduar aeronautik për ANP “Adem Jashari”; parashikime ditore për shtatë ditë në vazhdim; seksioni i tërthortë – nga niveli sipërfaqësor deri në 15 km lartësi; parashikimi rajonal - që përfshin një diametër prej 35 km; paralajmërimet e aerodromit (Aerodrome Warning) – në rast të kushteve jo të përshtatshme të motit për operime aeronautike duke u bazuar në kriteret; ditari i vëzhgimeve meteorologjike; si dhe përmbledhjet periodike vjetore dhe pesëvjeçare të të dhënave klimatologjike dhe statistikore. Të gjitha këto produkte të domosdoshme operative janë në shfrytëzim të pilotëve në çdo moment, por dhe udhëtarët gjatë fluturimit për në Prishtinë vazhdimisht informohen nga ekuipazhi i avionëve për kushtet e motit në ANP. Bazuar në pozitën gjeografike të ANP-së dhe lëvizjen e ujërave mbi dhe nëntokësore në dhe përreth ANP-së, ballafaqimi me kushte specifike të motit është i pashmangshëm. Konditat ekstreme si mjegulla, temperaturat ekstreme të ulëta dhe të larta sezonale, reshjet me intensitet dhe ditët e numërta me bubullima janë karakteristika që ndikojnë në sigurinë e operimeve.

Ndryshimet klimatike në dekadën e fundit pa dyshim kanë afektuar edhe vendin tonë. Interesimi i opinionit publik në lidhje me këto ndryshime gjithnjë e më tepër është në rritje, andaj përmbledhjet klimatologjike dhe statistikore të dhënave meteorologjike të përgatitura nga Divizioni Meteorologjik i ANP-Kontrolli Ajror “Adem Jashari”, përveç shfrytëzimit për nevoja aeronautike, gjithnjë e më tepër po rezultojnë me interesim të institucioneve të vendit për qasje në këtë pasuri, me qëllim të realizimit sa më të suksesshëm të projekteve madhore për vendin tonë.

Autori është Menaxher i Divizionit Meteorologjik në ANP-Kontrolli Ajror “Adem Jashari”



METEOROLOGICAL DIVISION – DIVIZIONI METEOROLOGJIK

7 DAY FORECAST

Day Date	Wednesday 26.02.2015	Thursday 26.02.2015	Friday 27.02.2015	Saturday 28.02.2015	Sunday 01.03.2015	Monday 02.03.2015	Tuesday 03.03.2015
Clouds							
And							
Weather							
T _{max} °C	11	13	12	12	15	12	15
T _{min} °C	02	02	03	03	04	04	03
Wind Dir.	110/14	350/10	140/10	140/10	340/10	140/10	140/10
Speed KT	03/13	03/10	03/07	03/08	03/08	03/08	03/10
Warning	Rain showers	-	-	-	-	-	Tail showers

This weather forecast applies only for the forecast date and is updated by a new 7 day forecast

Forecast by: Petrit Mubani

**NJËRI NGA PRODUKTET E DEPARTAMENTIT,
PARASHIKIMI 7-ditor**

Roboti Nao prezantohet para nxënësve



Top University Education for Top Students



- 14 vite Lider i Arsimit të Lartë - I vetmi i certifikuar për ekselencë
- I certifikuar sipas standardit ISO 9001:2008 për cilësi
- Përfutjes për herë të katërt nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfutjes i Programit për bursa AEP, Albach
- Përfutjes Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Shkencë dhe Inovacion

Zgjedh më të mirin ...

... që të bëhesh më i miri!

Come to UBT and Go International...

PROGRAMET E AKREDITUARA

- **MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (Baçelor dhe Master)**
 - Financa, Banka dhe Kontabilitet
 - Marketing dhe Shitje
 - Manaxhment dhe Ndërmarrësi
 - Logjistika dhe Menaxhimi i Prokurimit
- **SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (Baçelor dhe Master)**
 - Rrjeta dhe Telekomunikacion
 - Softuer dhe Sisteme Inxhinierie
 - Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
 - Dizajn dhe Multimedia
 - Mekatronikë dhe Robotikë

- MENAXHMENT I MEKATRONIKËS

(Baçelor dhe Master) (I vetmi i akredituar në vend)
(Elektroteknika, Elektronika, Teknologjia e Informacionit
Prodhimtaria Industriale, Dizajni Industrial
Ndërmarrësi dhe Menaxhment)

- SISTEMET E INFORMACIONIT (Baçelor dhe Master)

- Sistemet e Informacionit për Biznes
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Librarive dhe Menaxhimi i Dijes
- Statistika, Përpunimi i të dhënave dhe simulim
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia

- ARKITEKTURË

dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR (Baçelor dhe Master)
(I vetmi privat i akredituar në vend)

- INXHINIERI NDËRTIMOR (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURE (Baçelor)

(I vetmi privat i akredituar në vend)

- SHKENCA POLITIKE (Baçelor)

- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
- Integritime Evropiane
- Administratë Publike

- JURIDIK (LLB)

(Civile, Penale dhe Ndërkombëtare)

- MEDIA DHE KOMUNIKIM (Baçelor)

- POLITIKA PUBLIKE DHE MENAXHIM (Master)

- **INXHINIERI E ENERGIJË E FIKSUE (Baçelor)**
(I vetmi i akredituar në vend)

PËR UBT:

"UBT është krijuar si një universitet ndërkombëtar; një universitet modern që i përbush nevojat e një shoqërie dhe vendi demokratik, që në vazhdimësi është duke zhvilluar kapacitetet ekonomike dhe teknologjike."

Edmond Hajrizi, Rrektor i UBT-së

"Edukimi është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e bizneseve, që sot veprojnë ndërkombëtarisht, jo vetëm në hapësirën e Europës, por globalisht. UBT ju ofron mundësinë për të arritur qëllimet-objektivat ndërkombëtare"

"Profesorët e këtij universiteti janë më të mirët, dhe mund të shijojë që studimet tuaja në UBT janë më të mirat për të ardhmen tuaj si dhe të vendit tuaj, por edhe për një të ardhme më të mirë të Europës."

Dr. Erhard Busek Special Coordinator for the Stability Pact for SEE

REGJISTRIMI

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi

Gjuha e studimeve: Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze si dhe mundësia e studimit në gjuhë të tjera

Mënyra e studimit:

- UBT organizon ligjëratat të rregullta dhe me korrespondencë, si dhe ofron mundësinë e studimit në distancë.
- Për të punësuarit ofrohen ligjëratat pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

Që suksesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin student:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe çertifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Licença falas për software
- 100% Internship në kompanitë dhe institucionet me prestigjioze vendore dhe ndërkombëtare
- Libraria me numrin më të madh të titujve dhe qasja online në libratë me të mëdha elektronike
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë.
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Projekt, etj.
- Çertifikime për kontabilitet në bashkëpunim me SCAAK

Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik Baçelor është 1200 €, për nivelin Master është 1500 € me mundësi pagese deri në 12 kështe.
- Për të gjithë nxënësit e dalluar UBT ofron përkrahje financiare

UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik

Lagjia Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400 Email:info@ubt-uni.net Koha e regjistrimit çdo ditë prej orës 09:00 deri në 17:30

Apliko online: www.ubt-uni.net/apliko ose në qendrat për Informim dhe Regjistrim në Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Pejë dhe Mitrovicë



LEADERSHIP and INNOVATION



Recognised for excellence
4 star

I am the Excellence...